

NË GJYKATËN THEMELORE TË PEJËS

Lënda P. nr. 267/12

Data 3 mars 2015

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore e Pejës, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e Eulex-it Marie Tuma si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarit të Eulex-it Arkadiusz Sedek dhe gjyqtarit vendor Arben Mustafa si anëtarë të trupit gjykues si dhe procesmbajtësit Azem Havolli në lëndën penale kundër:

K.H., i lindur me XXX, në Bajram Curri Shqipëri, ku ai ende jeton, me kombësi dhe shtetësi shqiptare

akuzuar në bazë të Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës ("PSRK ") PP. numër 387/2006 të datës 26 mars 2007 e vërtetuar me aktvendimin KAQ 133/07 të datës 14 qershor 2007, e ndryshuar me një Ndryshim në Aktakuzë të datës 27 maj 2014 dhe të paraqitur në Gjykatë në shqyrtimin kryesor me 27 Maj 2014¹ me veprën në vijim:

Pika 2: Vrasje e rëndë në kundërshtim me nenin 147, pika (iv) e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ("KPPK"), dhe

¹ Me këtë ndryshim, prokurori tërhoqi Akuzën 1 përkatësisht akuzën e Bashkimit kriminal për të kryer veprën e vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 26 në lidhje me nenin 23 dhe nenin 147 pika (ix) e KPPK-së.

më parë i liruar nga Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin P.nr. 538/07 të datës 18 dhjetor 2007 të veprave penale të Vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 147, pika (iv) e KPPK-së dhe Bashkimit kriminal për të kryer veprën Vrasje e rëndë në kundërshtim me nenin 26 në lidhje me nenin 23 dhe nenit 147 pika (ix) e KPPK-së.

pas mbajtjes së gjykimit të hapur me 5, 15, 27 maj, 11 dhe 25 qershor, 9 dhe 31 korrik, 1 gusht, 5, 12² dhe 24 shtator dhe 24 tetor 2014³, 7 nëntor, 9 dhjetor 2014, 12 dhe 19 janar 2015, 5 shkurt, 2 dhe 3 mars 2015 në të cilat për Prokurorinë u shfaq Haxhi Sinani, palët e dëmtuara S.O., Sa.O., V.I. dhe A.B. ishin ose të pranishëm ose të ftuar, u shfaq M.R. si avokat për të pandehurin K.H., dhe në të cilat i pandehuri K.H. ishte vet i pranishëm dhe pas shqyrtimit dhe votimit më 5 shkurt, 2 dhe 3 mars 2015 shpall publikisht si më poshtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri, K.H.

Nën akuzën 2

² Kjo ishte për inspektim të vendit

³ Trupi gjykues gjithashtu ka kryer një inspektim të vendit me 12 shtator 2014

Nuk është ,

FAJTOR

Për shkak se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe nuk është provuar se ai ka kryer veprën penale të Vrasjes së rëndë në kundërshtim me Nenin 147, pika (iv) e KPPK-së, siç akuzohet në aktakuzë.

i. Kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues

Në pajtim me nenin 23 (1) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet ose vepra penale të dënueshme me burgim afatgjatë. Gjykata e Qarkut në Pejë ishte zëvendësuar nga Gjykata Themelore e Pejës me Ligjin mbi Gjykatat.⁴

Në rastin konkret i pandehuri ishte akuzuar për veprën penale të Vrasjes së rëndë, një vepër penale e dënueshme me burgim prej së paku 10 vjet.

Sipas aktakuzës vepra penale pretendohet të jetë kryer në Baicë, komuna e Istogut, Pejë, e cila është në territorin e Gjykatës Themelore të Pejës.

Nuk është ngritur asnjë çështje lidhur me juridiksionin e kësaj gjykate.

Me 29 shkurt 2012, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it në

⁴ Ligji nr. 04/L-199

pajtim me nenin 3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji nr. 03 / L053) lëshoi një Aktvendim për gjyqtarët e EULEX-it për të marrë përsipër këtë rast.

Për shkak të kësaj, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë ishte i përbërë në mënyrë të rregullt nga një trup gjykues i përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor në përputhje me nenin 4.7 të Ligjit mbi Juridiksionin. Nga palët nuk është ngritur asnjë çështje nga palët lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

ii. Historia Procedurale

Aktakuza PPHQ. nr 87/06 e datës 26 mars 2007 ishte ngritur fillimisht kundër pesë të pandehurve përkatësisht, K.H., A.K., S.K., Xh.K. dhe V.K. Lëndës iu kishte caktuar numri P. nr. 538/07.

Aktakuza akuzonte të pandehurit, me veprën e Bashkimit kriminal sipas nenit 26 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së në lidhje me veprën penale të Vrasje së Rëndë në pajtim me nenin 147, paragrafi 1, pika 9 e KPPK-së. Përveç kësaj, i pandehuri, K.H. ishte akuzuar i vetëm për veprën penale të vrasje të rëndë në pajtim me nenin 147 paragrafi 1 pika 4 e KPPK-së. Të pandehurit, K.H., Xh.K. dhe A.K. ishin akuzuar gjithashtu me posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit në kundërshtim me nenin 328 të KPPK-së.

Në thelb, faktet e pretenduara të këtij rasti ishin se i pandehuri, S.K. kishte kërkuar nga i pandehuri, K.H. dhe A.K. për të kryer një vrasje pranë qytetit

të Pejës, në gusht të vitit 2006. Në shënjestër ishte pala e dëmtuar, V.I. Pretendohej se për këtë qëllim të pandehurit, K.H. dhe A.K. ishin transportuar nga Shqipëria në shtëpinë e S.K. nga një palë e tretë. Atje atyre iu ishin dhënë detajet e viktimës nga të pandehurit, S.K., Xh.K. dhe V.K. të cilët më pas vozitën të pandehurit, K.H. dhe A.K. për të identifikuar veturën të cilës duhet t'ia zinin pritën. Të pesë të pandehurit pastaj u kthyen në shtëpinë e të pandehurit S.K. ku i pandehuri, V.K. i pajisi të pandehurit K.H. dhe A.K. me armë zjarri, telefona celular, SIM kartela dhe të holla. Të pandehurit, Xh.K. dhe V.K. pastaj transportuan të pandehurit, K.H. dhe A.K. në fshatin Baicë, ku ata do t'ia zinin pritën veturës së viktimës. Gjersa të pandehurit K.H. dhe A.K. ishin duke pritur u afrua një numër i njerëzve lokal, duke përfshirë edhe të ndjerin, J.O. i cili donte të dinte se kush ishin ata dhe nëse ata ishin aty në afërsi për të vjedhur një motoçikletë. Të pandehurit ikën në drejtime të kundërta. Megjithatë, disa orë më vonë i pandehuri K.H. i cili ishte kthyer përsëri u kontaktua nga i ndjeri, J.O.. Kësaj here ishin shkëmbyer të shtëna dhe J.O. kishte pësuar lëndime fatale.

Pas një shqyrtimi gjyqësor, Gjykata e atëhershme e Qarkut të Pejës kishte liruar të gjithë të pandehurit për dy veprat e lartpërmendura me aktgjykimin e datës 18 dhjetor 2007. Megjithatë, të pandehurit, Xh.K., K.H. dhe A.K. ishin dënuar për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve të zjarrit dhe ishin dënuar me një vit e katër muaj burgim të cilën periudhë tanimë ata e kishin kaluar në paraburgim. Prokurori parashtroi ankesë kundër lirimit. Me aktgjykimin e datës 27 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës konfirmoi ankesën e prokurorit, anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e referoi rastin për rigjykim. Gjykata e Lartë konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me dënimin për veprat penale të armëve të zjarrit.

Kur rasti u kthye për rigjykim ai ishte marrë përsipër nga gjyqtarët e EULEX-it dhe iu kishte caktuar numri P. nr. 542/11. Rigjykimi filloi më 7 maj 2012. Të pandehurit K.H. dhe A.K. ishin ftuar në mënyrë të rregullt, por nuk u paraqitën. Kryetari i atëhershëm i trupit gjykues kontaktoi autoritetet përkatëse në Republikën e Shqipërisë të cilët e dhanë mendimin e tyre se të pandehurit nuk ishin brenda juridiksionit të tyre. Me urdhër të datës 27 qershor 2012 kryetari i atëhershëm i trupit gjykues ndau çështjen kundër K.H. dhe A.K. dhe lëshoi urdhra vendorë dhe ndërkombëtar për arrestimet e tyre. Rastit kundër të pandehurve, A.K. dhe K.H. iu kishte caktuar numri P. nr. 267/12.

Tre të pandehurit e tjerë (S.K., Xh.K. dhe V.K.) u liruan me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 24 korrik 2012 kryesisht për shkak se të pandehurit, K.H. dhe A.K. nuk ishin në dispozicion për marrjen e tërthortë në pyetje prandaj dëshmitë e tyre nuk mund të përdoren kundër bashkë të pandehurve. Prokuroria i kundërshtoi këto lirime. Megjithatë, me aktvendimin PAKR. nr 1401/12 të datës 9 dhjetor 2013 Gjykata e Apelit e hodhi poshtë ankesën.

I pandehuri, K.H. ishte arrestuar në Suedi më 12 shtator 2013 dhe ishte futur në paraburgim në bazë të një urdhëri të paraburgimit të Gjykatës Themelore të Hudiksvall të datës 4 tetor 2014. Më 20 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Suedisë vendosi se nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për aprovimin e kërkesës për ekstradim të të pandehurit, K.H. në Kosovë. Më 20 mars 2014, qeveria e Suedisë kishte aprovuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për të ekstraduar të pandehurin, K.H. në Kosovë. K.H. nuk e ka dhënë pëlqimin për ekstradimin e tij. Ligji i aplikueshëm suedez është Ligji

mbi Ekstradimin në Çështjet Penale, 1957: 668 . I pandehuri, K.H. arriti në Prishtinë më 13 prill 2014. Ai u shfaq para trupit gjykues në Gjykatën Themelore të Pejës më 14 prill 2014 për një seancë dëgjimore për paraburgim dhe është mbajtur në paraburgim ku ai mbeti gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor.

B. Shqyrtimi gjyqësor

i. Ndryshimi i Aktakuzës

Aktakuza u konfirmua më 14 qershor 2007 në aktvendimin KAQ 133/07. Më 27 maj 2014 gjatë seancës së parë të ri-gjykimit prokurori paraqiti një ndryshim në aktakuzë me trupin gjykues ku ai tërhoqi Akuzën 1 përkatësisht akuzën e Bashkimit Kriminal për të kryer veprën e Vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 26 në lidhje me nenin 23 dhe nenin 147 pika (ix) e KPPK-së. Prokurori gjithashtu pati për qëllim për të ndryshuar pjesën e veçanta të Akuzës III përkatësisht veprën e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 2 i KPPK-së. Megjithatë, i pandehuri tanimë ishte dënuar për këtë vepër me aktgjykimin P.nr. 538/07 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 18 dhjetor 2007. Ky aktgjykim ishte konfirmuar me aktgjykimin Ap. Nr 267/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27 tetor 2011.

Në ndryshimin e njëjtë të aktakuzës prokuroria tërhoqi akuzën e Bashkimit Kriminal për të kryer veprën e vrasjes së rëndë kundër të pandehurit, A.K..

Me aktvendimin e datës 26 shtator 2014⁵ kryetari i trupit gjykues ndau rastin kundër të pandehurit, A.K.. Gjithashtu me aktvendimin e datës 26 shtator 2015, kryetari i trupit gjykues hodhi poshtë akuzën kundër të pandehurit, A.K.. Gjithashtu me letrat e datës 26 shtator 2014, kryetari i trupit gjykues kishte kërkuar tërheqjen e urdhër rreshtimeve vendore dhe ndërkombëtare të lëshuara më parë lidhur me të pandehurin, A.K..

Trupi gjykues ia theksoi këtë prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor më 1 mars 2015 dhe ia ofroi atij mundësinë për të tërhequr këtë akuzë por ai nuk kishte dashur që të bëjë këtë. Në rrethanat kur aktgjykimi i formës së prerë tashmë ishte arritur në lidhje me këtë akuzë trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor dha mendimin se nuk ishte më para gjykatës dhe nuk lëshoi asnjë aktgjykim në lidhje me të.

ii. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor ishin dëgjuar dëshmitarët në vijim dhe ishin administruar provat e mëposhtme

i. Deklaratat e dëshmitarëve

Deklaratat e dëshmitarëve në vijim janë të përfshira në shkresat e lëndës dhe janë futur si prova:

- (1) Intervista e Policisë së Kosovës me N.B., e datës 26 shtator 2006;
- (2) Intervista e Policisë së Kosovës me A.O., e datës 14 shtator 2006;

⁵ Vonesa ishte për shkak të shkujdesjes.

- (3) Intervista e Policisë së Kosovës me G.B., e datës 1 shtator 2006;
- (4) Intervista e Policisë së Kosovës me V.K., e datës 22 gusht 2006;
- (5) Intervista e Policisë së Kosovës me S.K., e datës 22 gusht 2006;
- (6) Intervista e Policisë së Kosovës me A.K., e datës 20 gusht 2006;
- (7) Intervista e Policisë së Kosovës me K.H., e datës 22 gusht 2006;
- (8) Intervista e Policisë së Kosovës me K.H., e datës 21 gusht 2006;
- (9) Intervista e Policisë së Kosovës me S.T., e datës 21 gusht 2006;
- (10) Intervista e Policisë së Kosovës me V.I., e datës 20 gusht 2006;
- (11) Intervista e Policisë së Kosovës me G.L., e datës 20 gusht 2006;
- (12) Intervista e Policisë së Kosovës me A.B., e datës 20 gusht 2006;
- (13) Intervista e Prokurorit me K.H., e datës 1 nëntor 2007;
- (14) Intervista e Prokurorit me A.K., e datës 20 tetor 2006;
- (15) Intervista e Prokurorit me S.K., e datës 16 mars 2007;
- (16) Intervista e Prokurorit me V.K., e datës 28 nëntor 2007;
- (17) Intervista e Prokurorit me Xh.K., e datës 16 mars 2007;
- (18) Intervista e Prokurorit me Sa.O., e datës 30 gusht 2006;
- (19) Intervista e Prokurorit me V.I., e datës 24 gusht 2006;
- (20) Intervista e Prokurorit me A.B., e datës 12 shtator 2006;
- (21) Intervista e Prokurorit me G.L., e datës 12 shtator 2006;

ii. Dëshmitarët me gojë

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarët në vijim:

Pala e dëmtuar / Dëshmitarja S.O.

Pala e dëmtuar / Dëshmitari A.B.

Pala e dëmtuar / Dëshmitari Sa.O.

Dëshmitari S.B.G.

Dëshmitari G.B.

Zyrtari i Policisë së Kosovës Ç.H.

Zyrtari i Policisë së Kosovës E.B.

Zyrtari i Policisë së Kosovës A.B.

Dr. A.G.

I.III Provat e dokumentuara

iii. Provat e padiskutueshme

Nuk kishte asnjë kontest se rreth orës 05: 45 më 20 gusht 2006 në fshatin Bajicë, në komunën e Istogut, në kryqëzimin e rrugëve Banjë- Istog-Pejë ka ndodhur një shkëmbim zjarri në mes të pandehurit, K.H. dhe viktimës J.O.. Si rezultat i kësaj, viktimë, J.O. ka pësuar lëndime fatale dhe edhe pala e dëmtuar A.B. kishte pësuar lëndim.

Nuk kishte asnjë kontest se viktimë J.O. për herë të parë ishte pranuar në Spitalin Regjional në Pejë para se të transferohej në QKUK në Prishtinë. Nga atje ai ishte dërguar në Gjenevë, Zvicër ku ai vdiq më 22 gusht 2006.

I pandehuri, K.H. kishte pranuar se kishte shkrepur armën që vrau J.O. dhe plagosi A.B.. Megjithatë, i pandehuri, K.H. argumentoi se ai kishte shtënë në vetmbrojtje. Ai pohoi se i ndjeri J.O. kishte shtënë së pari në të dhe kishte vazhduar të qëllojë në atë gjersa ai përpiqej të largohej.

iv. Dëshmia e dëshmitarit para kësaj Gjykate

Gruaja e të ndjerit J.O., pala e dëmtuar S.O. dha dëshminë e saj gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 27 maj 2014. Ajo deklaroi se ajo zakonisht banon në Zvicër me burrin e saj të ndjerë, por në gusht 2006 kishin ardhur në shtëpinë e tyre në fshatin Banjë për pushime me tre nga katër fëmijët e tyre.

Ajo ka deklaruar se shtëpia është një shtëpi dy-katëshe dhe familja banonte në të dy katet. Ajo ka deklaruar se ajo e ndante dhomën e gjumit me burrin e saj në katin e dytë dhe djemtë e saj dhe e bija gjithashtu flinin në katin e dytë. Ajo konfirmoi se familja kishte një veturë dhe një motoçikletë në shtëpi. Ajo deklaroi se motra e saj S. përkujdesej për shtëpinë kur familja ishte në Zvicër.

S.O. ka deklaruar se në natën e 19 gushtit 2006 deri në mëngjesin e 20 gushtit 2006 ajo ishte në shtëpi me fëmijët e saj. Burri i saj i ndjerë, J.O. ishte duke luajtur shah në shtëpinë e vëllait të tij. Ajo theksoi se "ne" pamë dy apo tre persona prapa shtëpisë. Ajo deklaroi se djali i saj L. (O.) dhe nipi Sa. (O.), erdhën në shtëpi me motoçikletë. Në pjesën e pasme të shtëpisë ata u ndeshën me të pandehurin K.H. dhe një tjetër mashkull. Ajo deklaroi se nipi i saj, Sa.O. i pyeti ata: "*Çfarë po bën këtu te shtëpia, te dritaret?*" Ata u përgjigjën: "*Ne kemi ardhur nga Shqipëria. Nuk kemi ku të qëndrojmë.*" Sa.O. iu kërkoi atyre ndonjë dokument identifikimi të cilin në fillim i pandehuri, K.H. nuk deshë t'a jap, por më vonë ajo tha "*ata ia treguan dokumentet*".

S.O. deklaroi se pastaj i pandehuri, K.H. iku dhe edhe mashkulli me të u arratis "*prapa mullarëve të barit*". Ajo deklaroi se djali i saj, L. thirri babain e tij, të ndjerin, J.O. dhe gjersa ai ishte në rrugë për në shtëpi ai e kishte kapur mashkullin i cili kishte tentuar të ikë dhe të fshihet pas mullarëve të barit dhe e kishte sjellur atë në shtëpi. I pandehuri, K.H. nuk ishte kapur atëherë.

S.O. deklaroi se në shtëpi, burri i saj i ndjerë, J.O. e kishte pyetur këtë mashkull "*Çfarë doni këtu?*" dhe ai ishte përgjigjur, "*ne kemi hyrë në mënyrë që të shohim apo kërkojmë motoçikletën.*" Ajo tha se J.O. pastaj e thirri Policinë e Istogut. S.O. deklaroi se derisa ishin duke e pritur policinë për të arritur, J.O. përsëri e pyeti mashkullin pse ai ishte atje? Ajo deklaroi se ai u përgjigj "*Ne jemi bashkëpunëtorë të S.K.*" S.O. pastaj tha se ky mashkull deklaroi "*Ne jemi bashkëpunëtorë të S.K. dhe ne jemi këtu për të vranë V.I.*" Ajo tha se pas dhjetë minutave mbërriti Policia e Istogut dhe e dërgoi në Istog dhe kjo ndodhi rreth orës 3:00 në mëngjes.

S.O. deklaroi se pasi që policia e mori këtë njeri familja qëndroi në shtëpi. Ata qëndruan të zgjuar deri në ora 05:45, kur dëgjuan "*një zhurmë, një tingull, një të shtënë; Unë nuk jam i sigurt se çfarë ishte ajo jashtë*". S.O. pastaj deklaroi se kjo zhurmë ishte "*dikush po e godiste derën*". Ajo deklaroi se burri i saj, J.O. tha, "*Po dal jashtë shpejt*" dhe kjo ishte dhjetë minuta më vonë rreth orës 06:00, pas së cilës ajo kishte fjetur.

S.O. deklaroi se dhjetë minuta më vonë, ajo dëgjoji të shtëna nga pistoletat. Ajo deklaroi se ajo e thirri motrën e saj dhe kunatin e saj dhe u tha atyre: "*Mendoj se e vranë J.*". S.O. ishte brenda në shtëpië e saj por ajo fillimisht

deklaroi se ishin pesë të shtëna dhe këto vazhduan derisa burri i saj arriti në udhëkryq. Ajo deklaroi se ajo e dinte këtë, sepse ajo e thirri nipin e saj dhe kunatin të cilët të dy erdhën në vendin e ngjarjes shpejt dhe e gjetën atje burrin e saj të vrarë ose të plagosur. Ajo ka deklaruar se nipi i saj Sa.O. e mori atë nga atje për t'a dërguar në Pejë për ndihmë të parë.

S.O. deklaroi se ajo ishte në dhomë me burrin e saj të ndjerë menjëherë para se ata të dëgjonin zhurmën dhe ai doli jashtë. Ajo tha se ai kishte të veshur pantallona të shkurtra, fanellë dhe një palë pantofla të thjeshta. Ajo ka deklaruar se nuk ka parë asgjë që ai ka mbajtur në dorë kur ka dalur jashtë.

S.O. kishte deklaruar se nuk kishte më shumë se pesë minuta në mes të të pesë të shtënave që ajo dëgjoji fillimisht me të shtënën e fundit. Ajo deklaroi se të gjitha të shtënat e dëgjuara u gjuajtën pasi burri i saj doli jashtë. S.O. nuk ka mund të thotë nëse zhurmët e të shtënave ishin të njëjta ose të ndryshme. Ajo ka deklaruar se ajo ka dalë jashtë brenda pesë minutave pasi që janë ndalur të shtënat. Ajo ka deklaruar se e ka thirrur emrin e burrit por nuk e ka parë atë para se nipi i saj t'a kishte dërguar në spital. Ajo ka deklaruar se vendi në të cilin burri i saj ishte gjetur ishte më afër shtëpisë së saj sesa shtëpisë së Sa.O.. Ajo ka deklaruar se kur ajo ka dal jashtë ka pa një person tek një pemë arre. Ajo ka deklaruar se ajo e njeh dëshmitarin A.B., por nuk e kishte parë atë në mëngjes. Ajo ka deklaruar se nuk e njeh G.L..

Në përgjigje të pyetjes nga kryetari i trupit gjykues, S.O. ka deklaruar në fillim se ajo ka dëgjuar pesë të shtëna por më vonë ishin edhe tre të shtëna dhe kishte rreth tre deri në pesë minuta në mes breshërisë së këtyre shkrepëtimitave të armëve të zjarrit.

S.O. ka deklaruar se pasi burri i saj ishte larguar nga shtëpia e tyre herën tjetër kur ajo e pa atë ishte në spital në Prishtinë para se kompania e tij e sigurimeve nga Zvicra kishte ardhur dhe e kishte dërguar atë në Gjenevë ku ai vdiq. S.O. ka deklaruar se vajza e saj ishte me të në Gjenevë.

S.O. ka deklaruar se familja ishte informuar se burri i saj ishte duke u përmirësuar kur ishte në Prishtinë, por kur ata e morën atë në Gjenevë ata thanë se "*plumbi ishte shpërndarë brenda kokës së tij*" dhe "*i gjithë truri i tij ishte dëmtuar*" dhe ai vdiq.

Në përgjigje të pyetjeve nga avokatët mbrojtësit, S.O. deklaroi se së pari kur ajo e kuptoi se një i huaj kishte hyrë në shtëpinë e saj ishte kur djali i saj (L.) dhe nipi (Sa.) erdhën dhe ata e vërejtën se dikush ishte te dritarja. Ajo ka deklaruar se kjo ishte përafërsisht rreth orës 20:30.

S.O. ka deklaruar se kur burri i saj e ka zënë mashkullin duke u kthyer nga loja e shahut; e kishte kthye atë prapa në shtëpinë e familjes dhe e kishte pyetur nëse ai donte diçka për të pirë? Ajo tha se mashkull u përgjigj me "jo" para se ata të kishin një bisedim për qëllimin e pranisë së tij atje dhe marrëdhëniet e tij me S.K.. Ajo konfirmoi se ajo kishte qenë e pranishme dhe se e kishte dëgjuar këtë bisedë.

S.O. deklaroi se ajo nuk e njohte V.I. por ajo i dëgjoji të dy meshkujt që pranuan se ata ishin aty për t'a vrarë atë. Ajo përsëriti dëshminë e saj të mëhershme në lidhje me shkrepjen fillestare të të pesë të shtënave të pasuara nga tri të shtëna të fundit pak më vonë.

S.O. deklaroi se ajo e vizitoi burrin e saj në Prishtinë por ai ishte pa vetëdije dhe ajo nuk ishte në gjendje për të komunikuar me të.

Në përgjigje të pyetjes nga kryetari i trupit gjykues, S.O. pranoi se gjatë gjykimit të parë të këtij rasti ajo kishte deklaruar se burri i saj kishte dalë nga shtëpia me një pistoletë, por tani ajo deklaronte se nuk mund të ishte e sigurt për këtë.

Pala e dëmtuar **A.B.** dha dëshminë para trupit gjykues në seancën e datës 11 qershor 2014.

Më parë, më 12 shtator 2006 ai dha një deklaratë para Prokurorit të Qarkut në Pejë, gjatë së cilës ai deklaroi se në mëngjesin e datës 20 gusht 2006 ai ishte në fshatin Baicë, ku ai punonte si një oficer i sigurimit për një depo dhe një dyqan ushqimorë. Ai deklaroi se gjersa ai ishte brenda një kioske para dyqanit të ushqimeve, një njeri të cilin ai vetëm e dinte që ishte nga Baica iu afrua atij dhe e pyeti nëse ai kishte parë ndonjë gjë. A.B. iu kishte përgjigjur se ai nuk kishte parë asgjë dhe ishte kthyer në depo për të konfirmuar se gjithçka ishte në rregull. Gjersa ai ishte duke qëndruar ai e pa përsëri atë burrin që ai e njohte nga Bajica dhe këtë herë ai ishte duke folur me një person tjetër i cili ishte më i ri dhe ata ishin duke ecur në drejtim të Gurakocit. A.B. deklaroi se ai nuk mundi të dëgjojë se për çfarë ata ishin duke biseduar.

Ai pohoi se pas dy minutave ai i pa ata përsëri duke u kthyer në rrugën për Pejë dhe gjersa ata po vinin më pranë atij, personi më i ri i tha atij që të mos

lëvizte, ose ai do të vriste atë. A.B. deklaroi se ai nuk kishte lëvizur, por vetëm kishte dëgjuar. Ai theksoi se personi më i ri ishte përpara kurse personi tjetër që ai e kishte parë më parë ishte duke qëndruar pas tij. A.B. deklaroi se në një distancë prej rreth 35 metrave ai kishte dëgjuar të shtëna dhe pas të shtënës së tretë, ai ndjeu që diçka po i digjte krahun dhe ai e pa gjakun dhe kuptoi se kishte pësuar me lëndime. A.B. pohoi se të dy burrat ishin duke mbajtur armë por ai nuk e di se çfarë lloji të armëve. A.B. pohoi se të dy burrat ishin duke shtënë "*kundër njëri-tjetrit*". Ai pohoi se ata ishin duke vrapsuar njëri pas tjetrit dhe ata kishin një distancë mes tyre prej rreth 10 metrave dhe se njëri prej tyre po e ndiqte tjetrin.

Në dëshminë e tij para trupit gjykues më 11 qershor 2014, A.B. konfirmoi se atë kohë ai ishte duke punuar si një roje e sigurimit në një ndertësë në Baicë. Ai e kishte marrë detyrën në ora 18:00 dhe do të qëndronte deri në mëngjes. Ai ka punuar i vetëm.

A.B. ka pohuar se në mëngjesin e datës 20 gusht 2006 rreth orës 5:45 ai e kaloi rrugën në anën tjetër për të marrë ujë. Pas kthimit të tij në depo për të cilën ai ishte përgjegjës për ruajtje, ai vërejti dy njerëz që dilnin nga rruga që çonin në Kashticë. Ai deklaroi se ata ishin rreth 50 metra larg dhe drita ishte e mirë. Ai deklaroi se ai nuk e njihte asnjërin person.

A.B. deklaroi se këta dy persona arritën në rrugën Pejë – Gurakoc, ata ishin së bashku dhe me siguri bisedonin njëri me tjetrin. Ata po i afroreshin atij dhe iu afruan aq afër sa edhe gjerësia e rrugës për tek ai.

A.B. përshkruajti njërin nga personat si "*më i vjetër*". Ai tha se personi tjetër

ishite "më i ri". Ai deklaroi se personi më i vjetër mund të ketë qenë diku rreth 40 - 45 vjeçar gjersa i riu duhet të ketë qenë në mes të moshës 20-25 vjeçare. Ai deklaroi se flokët e personit më të ri ishin "të errëta, të kuqërremta" dhe ishin të gjatë deri në qafën e tij. A.B. deklaroi se kur ata ishin një distancë prej 5-6 metrave ai e kuptoi se ata ishin duke folur njëri me tjetrin por ai nuk mund t'i dëgjonte se çfarë ata ishin duke thënë. Ai tha se në këtë pikë i riu u shkëput nga personi më i vjetër në drejtim të pompës së benzinës.

A.B. tha se nuk ka mundur të dëgjojë se çfarë ishin duke thënë, por që në atë moment i riu u nda nga më i vjetri duke e marrë rrugën e tij në drejtim të pompës së benzinës. A.B. tha se i riu ishte duke vrapuar dhe kur erdhi aty ku A.B. qëndronte ai tha "mos e kalo rrugën, ose do të të vras". A.B. nuk mundi të thoshte nëse personi kishte pasur ndonjë gjë në dorë. Megjithatë, i riu vazhdoi të vrapojë dhe ai ndiqej nga personi më i vjetër. A.B. pohoi se kur personat ishin rreth 30-35 metra larg nga ai, ai ka dëgjuar të shtënat. A.B. deklaroi se personi më i vjetër ishte përafërsisht 5/6 metra pas të riut. Ai nuk ka mund të shoh nëse ndonjëri prej tyre kishte ndonjë gjë në duart e tyre. A.B. deklaroi se iu duk atij se ata të dy kanë shtëna. A.B. ka thënë se me siguri ai ishte plagosur nga më i riu. Ai deklaroi se kurdo që i riu shtiente atij iu dashke të kthehej dhe të shtiente në drejtim të personit tjetër, më të vjetër. Ai nuk besonte se ai ishte plagosur nga personi më i vjetër pasi që ai ishte duke shtëna para tij. A.B. ka deklaruar se ai ka pësuar një plagë në krahun e tij të djathtë. A.B. ka përsëritur se ai nuk kishte e parë asnjërin me armë pasi që ata ishin duke vrapuar larg nga ai. Megjithatë, ai deklaroi se ai e dinte se e shtëna që e goditi atë kishte ardhur nga personi më i ri, sepse "në mënyrë që të shtiej në drejtimin tim, [atij] iu dashte të ndalnte dhe të

shtiente në drejtim të personit më të vjetër".

A.B. ka deklaruar se distanca mes të dy burrave ishte 7-8 ose 10 metra. Ai ka deklaruar se kishte pasur disa të shtëna-nganjëherë të shtëna individuale dhe nganjëherë shpërthim i dy ose tre plumbave. A.B. ka deklaruar se të shtënat kishin ardhur nga armët e vogla dhe të dy të shtënat e para erdhën "pa ndërprerje". Ai e dha mendimin e vet se të shtënat kishin ardhur nga armët e kalibrave të ndryshëm. Ai u shpreh se zhurma e armës që shtiente në drejtim të tij ishte më e madhe dhe zhurma e armës që shtiente në drejtimin tjetër ishte më e vogël. Ai deklaroi se në atë kohë ai nuk mendoj se i riu ishte në gjendje që të qëllojë ndonjë gjë pasi që ai ishte duke ikur.

Prokurori ia parashtrroi A.B. pyetjen se në deklaratën e tij në polici ai kishte thënë se ai kishte pa dy persona duke ikur me armë në duart e tyre, por tani ai deklaronte se nuk kishte pa asnjë armë. A.B. deklaroi se incidenti ka ndodhur rreth tetë vjet më parë dhe të dy deklaratat ishin të sakta. Ai theksoi se deklarata e tij në polici në vitin 2006, ishte e vërtetë: pasi që ngjarjet në atë kohë ishin të freskëta në mendjen e tij.

Prokurori pastaj ia parashtrroi pyetjen A.B. se në dëshminë e tij para trupit gjykues ai kishte deklaruar se ai nuk kishte mundur të dëgjoj nëse personat ishin duke folur me njëri-tjetrin, por në faqen 3 të deklaratës së tij në polici ai kishte deklaruar, "*Unë e vërejta që i riu po vraponte në drejtim të Banjës, kurse personi nga Banja ishte duke vrapuar pas tij duke i thënë që të ndalonte e të mos ikte. Sapo që i riu doli përballë meje në anën tjetër të asfaltit unë i thashë atij 'ndalo, çfarë po ndodh mes juve të dyve. Ai më tha që të mos lëvizja ose do të të vras. Ai vazhdoi në rrugën e tij pa u ndalur së*

vrapuari. Personi tjetër po vraponte pas tij dhe unë e vura re se ai kishte një armë dore në dorën e tij me ngjyrë të zezë dhe posa që ata kaluan shtëpinë rreth 15 metra unë dëgjova të shtënat e pistoletës, ku të dy po shtienin në njëri-tjetrin. Kur unë e dëgjova të shtënën e katërt apo të pestë krahu im u nxeh dhe unë menjëherë e kuptova që unë isha plagosur nga personi i parë i cili po ikte dhe i njëjti sipas zërit të tij kur ai më foli mua ishte nga Shqipëria”.

A.B. ka konfirmuar se ai e ka deklaruar këtë në polici në vitin 2006. Ai deklaroi se atij i kujtohej deklarata e tij në polici dhe kujtesa e tij ishte aq e freskët sikur ngjarja të ketë ndodhur atë ditë.

A.B. ka deklaruar se ai ishte dërguar në spital nga shefi i pompës së benzinës, M.F.. A.B. deklaroi se S.B. mund të ketë qenë i pranishëm atë natë. A.B. deklaroi se pasi që kishte pësuar lëndim ai nuk e kishte parë të riun dhe personin më të vjetër duke e ndjekur atë.

Prokurori pastaj ia parashtrroi atij pyetjen se në deklaratën e tij në polici menjëherë pas ngjarjes A.B. kishte deklaruar: "*Unë e pashë shitësin që punonte në pompën e benzinës emri i të cilit është S.B. ose G. dhe ai është nga fshati Sudenicë. Unë e pyeta S. se a e kishte parë se çfarë ka ndodhur, ai tha se po dhe se njëri prej tyre është i vdekur. Unë e pashë se personi nga Banja që vraponte pas atij nga Shqipëria ishte i shtrirë në kurriz e tij dhe këmbët e tij në drejtim të rrugës Banja dhe koka e tij në drejtim të dritares së depos. Unë e pyeta S. a je i sigurtë dhe i gjallë dhe ai tha po sepse ai ishte fshehur pas shtyllave të betonit. Më tej S. më tha se ky personi tjetër kishte ikur në drejtim të misrit në drejtim të Banjës mbi rrugën "*. A.B. e kishte

konfirmuar se kjo ishte korrekte dhe e saktë.

A.B. deklaroi se ai nuk e njihte viktimën J.O. por ai e njihte S.B..

A.B. deklaroi se ai mund të tregonte vendin e ngjarjes ku ai ishte plagosur edhe pse vendi tani kishte ndryshuar pak pasi që rruga ishte riparuar me asfalt të ri dhe gjëra të tilla.

A.B. deklaroi se gjithashtu mund të tregojë vendin ku ishin i riu dhe personi më i vjetër kur ai ishte plagosur por ai nuk mund të thoshte se sa metra larg ishte ai.

A.B. deklaroi se ai e njihte Sa.O. nga fshati Baicë. Ai tha se ai i kishte folur atij në mëngjesin e datës 20 gusht 2006 dhe Sa.O. deklaroi se ai kishte dëgjuar se ishin qëlluar të shtëna.

A.B. ka deklaruar se ai e njihte G.L. por nuk kanë pasur kontakte të shpeshta me të. Ai ka deklaruar se ai e kishte parë atë natë atë por nuk mundi të thoshte nëse ai kishte qenë i pranishëm kur kishin ndodhur të shtënat. A.B. kishte deklaruar se përveç Sa.O. dhe G.L. ka mundur të ketë pasur persona të tjerë të pranishëm, por ai nuk mund të ishte i sigurt megjithatë, ai that se kishte qenë mëngjes dhe njerëzit ishin duke shkuar në punë.

Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës, A.B. deklaroi se ishte e mundur që i njëjti person të cilin ai e pa duke e ndjekur personin më të ri të ishte i njëjti person i cili e kishte pyetur atë nëse ai kishte parë ndonjë gjë të pazakontë.

Avokati mbrojtës pastaj ia parashtrori pyetjen A.B. se në deklaratën e tij të Policisë së Kosovës më 12 shtator 2006 ai kishte thënë: "*Më duhet të shtoj se kur ata kaluan kah unë njëri pas tjetrit të dy personat kishin armë në duart e tyre*", dhe e pyeti nëse ai i kishte parë armët.

A.B. deklaroi se nëse atëherë ai kishte thënë se ata kishin armë atëherë kjo është e saktë. Ai ka deklaruar se ai nuk e dinte nëse personi më i vjetër i kishte thënë atij ndonjë të keqe, por ai ishte i sigurt që i riu i kishte thënë atij: "*Mos kalo në këtë anë, ose do të të vras*".

A.B. ishte pyetur nëse personi i dytë i kishte thënë atij "*Ndaloje atë!*" dhe e kishte sharë personin më të ri dhe ai u përgjigj se atij nuk i kujtohet, por ai ka mund t'a ketë bërë këtë. Ai deklaroi se personi më i ri i kishte thënë atij "*Ndalu aty, mos e kalo rrugën, ose do të të vras*".

Avokati mbrojtës e pyeti A.B. nëse ai e dinte se a kishte ndonjë marrëdhënie familjare midis Sa.O. dhe personit të dytë më të vjetër i cili ishte duke e ndjekur dhe ai tha se në atë moment ai nuk dinte për ndonjë lidhje familjare, por më vonë duke u kthyer nga spitali ai i kishte dëgjuar njerëzit duke folur në lidhje me të dhe mori vesh se ai ishte xhaxhai i Sa.O..

A.B. nuk mundi të thoshte sa kohë pasi që të shtënat u ndalën u shfaq Sa.O. ose nëse të shtënat kishin ndaluar apo jo pasi që kishte pasur shumë njerëz përreth dhe duke ikur. A.B. dha mendimin e tij se G.L. ka mund të ketë punuar në dyqan menjëherë pas pompës së benzinës duke shitur dritare.

Prokurori e pyeti A.B. pse dikush të cilin ai nuk e njohte do të thoshte diçka

të tillë si "Ndaluhet të vrasësh, mos e kalo rrugën, ose do të të vras?" A ka dashur A.B. të shkonte para tij dhe ta kapte atë apo dikush i kishte thënë atij që të shkonte dhe ta kapte atë?

A.B. deklaroi se deri në atë moment ai nuk e dinte se do të kishte një konflikt midis njerëzve. Ai deklaroi se qëllimi i tij i vetëm në atë pikë ishte që të kaloj rrugën.

Në përgjigje të pyetjes nga i pandehuri K.H., A.B. deklaroi se emri i ndërtesës në të cilin ai punonte ishte "*Ditori*". Ai poashtu e konfirmoi se ku ishte kjo në fshat. A.B. gjithashtu ka deklaruar se personi më i vjetër erdhi nga ana e djathtë para supermarketit në rrugën për në Kashice dhe i pandehuri do t'a kishte ditur këtë pasi që ai ishte duke u ndjekur nga ai.

Në përgjigje të pyetjes nga kryetari i trupit gjykues, A.B. kishte deklaruar se ai kishte armë që 35 vjet dhe ai konfirmoi se kishte zhurma të ndryshme nga një armë më e vogël dhe nga një armë më e madhe. Ai deklaroi se arma që kishte një zhurmë më të madhe do të duhej të ishte e kalibrit më të madh. Megjithatë, ai pohoi se ai nuk mund të thoshte se e çfarë kalibri ishte arma nga e cila ai ishte plagosur.

A.B. nuk mundi të thoshte se cili prej dy meshkujve që vraponin kishte shtënë i pari. Megjithatë, ai deklaroi se ai e pa se të riut iu dasht që të ndaloj e të kthehet për të gjuajtur dhe ai e mbante armën në dorën e djathtë në drejtim të personit të dytë.

A.B. ka konfirmuar se ai nuk i ka parë të gjitha të shtënë, por ai ishte i

sigurtë se kishte parë disa prej tyre. Ai ka deklaruar se çdo gjë ishte zhvilluar shumë shpejt dhe ka pasur momente dhe vende kur i riu kthehej dhe shtiente dhe këto ishin lëvizje të shpejta. A.B. ka deklaruar se "*askush*" nuk ka mundur të shoh nëse ky person kishte diçka në shënjestër por ai nuk mendon se ai ka pasur ndonjë gjë pasi që ai ishte duke ikur.

A.B. ka deklaruar se ai e kishte parë personin më të vjetër duke shtënë dy ose tri herë para tij në drejtimin e personit të parë më të ri. A.B. deklaroi se dy apo tri të shtëna ishin qëlluar nga personi më i vjetër kundër më të riut menjëherë kur ata filluan të shtienin në njëri-tjetrin. Ai ka deklaruar se flokët e personit më të ri ishin të gjata dhe të lidhura pas. Fytyra e tij ishte e gjatë. Hunda e tij ishte e gjatë dhe dukej sikur të kishte një kërrabë në fund. Veshja e tij ishte sportive dhe e lehtë. A.B. deklaroi se ai nuk e kishte zgjedhur këtë person në ndonjë formular të paradës së identitetit por ai e kishte njohur atë menjëherë. A.B. pastaj bëri me gisht kah i pandehuri K.H. dhe tha se ishte i sigurt se ky ishte ai personi më i ri në incident.

A.B. ka deklaruar se ai nuk ishte i sigurt nëse dy të burrat ishin duke shkëmbyer fjalë gjersa ata po i afroreshin atij në atë mëngjes. Ai tha se ishte një zhurmë nga një automjet e cila e mbyste këtë. Ai tha kur ai ishte marrur për tu dërguar në spital në Pejë gjersa ai po kalonte ai kishte parë një turmë njerëzish dhe një person të shtrirë në asfalt. Ai deklaroi se gjersa të dy personat ishin duke shtënë në njëri-tjetrin ai nuk e kishte parë askënd të binte poshtë.

A.B. pastaj deklaroi se kishte edhe të shtëna të tjera të cilat ishin shtënë para se të shkrepeshin dy-tri të shtënat nga personi më i vjetër kah personi më i

ri. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk e kishte vëzhguar nëse ndonjëri prej të dy personave ishte më aktiv në të shtënat se tjetri.

Dëshmitari **S.B.G.** dha deklaratën para trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor më 9 korrik 2014.

Në dëshminë e tij para trupit gjykues dëshmitari S.B.G. deklaroi se ai punonte si një ndihmës në pompën e benzinës MTF në Baicë. Ai deklaroi se pika e karburantit gjendet në rrugën Banjë-Istog në anën e majtë që shkohet në drejtim të Istogut.

S.B.G. ka deklaruar se në natën e 19 gusht 2006 ai e përfundoi punën në mesnatë dhe duhej të raportonte prapë për detyrë në ora 07:00 prandaj ai fjeti brenda pompës së benzinës. Ai deklaroi se askush tjetër nuk ishte aty.

Ai deklaroi se në atë mëngjes ai dëgjoji një zhurmë, por ai nuk kishte dalur jashtë menjëherë, por në vend të kësaj ai priti derisa gjërat u "*qetësuan*". Ai deklaroi se ai besonte se ishte ora 06:30. S.B.G. deklaroi se ishte përgjegjësia e tij për të dorëzuar ndërrimin në ora 09:00 dhe ai e bëri këtë, por ai nuk e mbante mend kujt.

S.B.G. deklaroi se më vonë mu atë ditë ai dëgjoji se një person ishte plagosur dhe se emri i tij ishte J.O.. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk e dinte se nën çfarë rrethanash ai ishte plagosur.

S.B.G. deklaroi se pika e karburantit në të cilën ai punonte ishte në rrugën

kryesore. Ai pranoi se dëgjoi të shtëna atë mëngjes por nuk mund të thoshte se sa të shtëna dëgjoi. Ai deklaroi se e njihte A.B. dhe se e kishte parë atë në atë natë por se vetëm para mesnatës dhe jo pas mesnate. S.B.G. deklaroi se ai u largua nga pika e karburantit vetëm sa për të shkuar në tualet dhe se nuk ishte puna e tij që të bënte sigurimin.

S.B.G. deklaroi se e njihte J.O. si myshteri.

Në përgjigje të pyetjes nga avokati mbrojtës S.B.G. deklaroi se nuk e pa të ndjerin J.O. gjatë ditës apo herët ditën e nesërme. Ai deklaroi se nuk e di se kush i ofroj atij ndihmën e parë apo se kush e dërgoi atë në spital.

S.B.G. deklaroi se kur gjërat u qetësuan dhe ai doli, ai dëgjoi zhurmë dhe se ajo zhurmë ishte të shtëna armësh. Megjithatë, ai deklaroi se nuk mund të thot se nga vinin të shtënat. Ai deklaroi se doli jashtë sepse ishte koha që të fillonte punën. Ai deklaroi se dëgjoi më shumë se tri apo katër të shtëna.

S.B.G. deklaroi se kur ai dëgjoi këto 3 apo 4 të shtëna ai mendoj se zakonisht në atë kohë njerëzit gjuajnë qentë sepse kjo gjë ishte e zakonshme në atë anë.

Dëshmitari **G.B.** dha dëshmi para këtij trupi gjykues të shqyrtimit kryesor me datë 1 Gusht 2014. Më përpara ai dha deklaratë në Policinë e Kosovës me datë 1 Shtator 2006.

Në deklaratën e tij në Policinë e Kosovës, dëshmitari G.B. deklaroi se me

datë 20 Gusht 2006 rreth orës 05:30 ai po dilte nga shtëpia e tij me të motrën e tij E. me veturën ‘Peugout 106’ me ngjyrë të kuqe me targa regjistrimi Italiane. Ai po udhëtonte për në Pejë për ta dërguar të motrën në punë. G.B. deklaroi se përafërsisht rreth orës 05:50 minuta gjersa po udhëtonte përgjatë rrugës kryesore Istog –Pejë, afër shtëpisë së J.O., ai vuri re dy njerëz duke vrapuar përgjatë rrugës kryesore njeri pas tjetrit në drejtim të udhëkryqit të Banjës në drejtim të Pejës.

G.B. deklaroi se ai nuk e dinte se kush ishin ata njerëz, por se ai deklaroi se i pari që dukej se po ikte ishte rreth të 20-ve dhe se flokët i kishte të gjata deri në shpatulla, ndërsa tjetri ishte pas tij dhe se dukej se po e ndiqte mashkullin e parë. G.B. deklaroi se burri i dytë kishte të veshura pantallona të shkurta deri në gjunjë. G.B. deklaroi se nuk e njohte asnjërin nga këta burra. Ai deklaroi se largësia mes këtyre ishte diku rreth 10 – 15 metra, gjersa ai vetë ishte diku 10-15 metra prej tyre.

G.B. deklaroi se ai po kalonte kah shtëpia e J.O., ai pa një tjetër person i cili ishte i ulur në një degë të arrës 2-3 metra nga toka duke vëzhguar ngjarjet. Ai deklaroi se këtij njeriu nuk i kushtoj shumë vëmendje dhe se tani nuk mund ta përshkruaj e as ta njoh. Ai po ashtu as nuk e di nëse ai kishte ndonjë gjë në dorë.

G.B. deklaroi se me të arritur rrugën për në fshatin Kashicë ai pa burrin e parë me pistoletë të shkurtër në dorën e tij të djathtë, drejtuar burrit të dytë *“në mënyrë të pa kontrolluar sepse ai ishte duke vrapuar”*. Ai deklaroi se papritmas ai dëgjoji një të shtënë arme por se nuk e dinte se kush po shtinte. Pas nja dy apo tre sekondash ai dëgjoji të shtënë tjetër por përsëri nuk e di se

kush po shtinte sepse ai nuk mund të shihte se kishte diçka në dorë personi i dytë a jo. Ai deklaroi se gjersa këta dy burra po vraponin vazhdonin të shtënat të shkrepnin.

G.B. nuk e dinte se sa të shtëna u shkrepën por e dinte se ishin rafalë të shtënash dhe se ai ishte i frikësuar dhe tmerruar sepse edhe të motrën e kishte me vete. Ai mban mend një veturë Audi 80 pra tij e cila ishte me ngjyrë të hirit të mbylltë por se nuk i kujtohet numri i regjistrimit. Ai deklaroi se kjo veturë e tejkaloi atë me shpejtësi normale duke shkuar në drejtim të Pejës.

G.B. deklaroi se kur të shtënat filluan ai ia doli të i tejkaloj këta dy njerëz në disa sekonda dhe ndërsa të shtënat vazhdonin ai nuk ishte i sigurt se kush po shtinte në të vërtetë sepse kishte frikë të kthehej prapa. Ai nuk mund të thoshte nëse personi i dytë kishte diçka në dorë a jo. Ai deklaroi se deri sa ai arriti te pika e karburantit tek udhëkryqi, këta dy njerëz tashmë ishin prapa tij. Ai deklaroi se voziti anash pjesës së parkimit të pikës së karburantit sepse kishte frikë se mos po qëllohej aksidentalisht sepse këta dy burra ishin në mes të rrugës kryesore. Ai deklaroi se e motra e tij i tha që të iknin nga ai vend menjëherë kështu që ai vazhdoi të shkonte në drejtim të Pejës në shpejtësi të madhe.

Ai deklaroi se vazhdoi të vështronte të dy burrat nëpërmjet pasqyrës së retrovizorit deri sa nuk i humbi nga pamja. Ai deklaroi se ata vraponin dhe se të shtënat vazhdonin të shkrepeshin dhe gjersa e kaloi bregun ai kuptoi se të shtënat u ndalën. G.B. deklaroi se nuk i kujtohej asgjë lidhur me incidentin përpos që u mundua të thërriste 112 (linjës emergjente të Policisë)

por se nuk ia doli ta kapte lidhjen. Ai deklaroi se me të arritur tek pika e karburantit “Drini” ai u ndesh me veturën e parë të policisë dhe i njoftoi ata për rastin. Ai deklaroi se e njohte të ndjerin, J.O. vetëm nga pamja dhe se dinte se ku e kishte shtëpinë.

G.B. deklaroi se për shkak të frikës që ai pati në kohën e incidentit, faktit që zgjati rreth tre apo katër minuta dhe se gjatë gjithë kohës pati të shtëna, ai nuk mund të thotë me siguri nëse ishte J.O. njeri nga ata që vraponte apo se ishte ndokush tjetër. Ai deklaroi se madje edhe tani po t’i shoh këta dy njerëz dhe të tretin të ulur në pemë ai nuk mendon se mund t’i njohte ata.

G.B. konfirmoi se dha deklaratë në Policinë e Kosovës me datë 1 Shtator 2006. Ai u pajtua se ka nënshkruar deklaratën por se ndërkohë ai deklaroi se i kishte *“harruar të gjitha”*.

G.B. deklaroi se dy burrat që pa në udhëkryqin e rrugës nga Kashtica dhe rrugës kryesore Pejë-Istog po vraponin në mes të rrugës përgjatë vijës së bardhë, largësia mes tyre ishte rreth tridhjetë metra por se nuk kishte parë më shumë sepse ai doli nga rruga ndali veturën.

G.B. deklaroi se të dy burrat kishin armë në duar por se ai nuk mund të thotë nëse këto armë ishin të shkurta apo të gjata. Ai deklaroi se të dy shtinin në njeri tjetrin.

G.B. nuk mund të përshkruaj asnjë nga personat. Ai deklaroi se nuk e njohte asnjërin nga ta e as që mund të thotë se kush shtiu i pari. Ai deklaroi se kur e ndali veturën ai qëndroi aty deri sa njerëzit shkuan në drejtim të Banjës por

se ai nuk pa se ku shkuan ata pas kësaj. Ai nuk mban mend të ketë parë njerëz të tjerë në atë afërsi.

G.B. deklaroi se “*personi i parë*” po shtinte dhe vraponte në të njëjtën kohë me kokë kthyer prapa por se nuk mund të thotë nëse të shtënat që ai shkrepri ishin rafal të shtënash apo një pas tjetrit e as që mund të thotë se sa të shtëna shkrepri personi i parë.

G.B. deklaroi se i dyti po ashtu vraponte dhe se shtinte në drejtim të personit të parë por se ai nuk mban mend pozitën e mbajtjes së armës së personit të parë e as që i kujtohet se sa herë shtiu ky person.

G.B. deklaroi se nuk e njihte J.O.. Ai deklaroi se dëgjoji më vonë atë ditë se një person u qëllua dhe kush ishte por përsëri ai se njihte atë.

Prokurori ia përkujtoi G.B. se ai deklaroi në polici se e njihte J.O. po ta shihte, por G.B. deklaroi se ai nuk e njihte atë dhe se nuk i kujtohej të kishte thënë se e ka njohur përpara.

Prokurori gjithashtu ia përkujtoi G.B. se ai deklaroi në polici që personi i parë ishte me flokë të gjata deri në qafë por G.B. deklaroi se nuk mban mend të ketë thënë këtë gjë.

G.B. pastaj deklaroi se ai ishte 60-70 metra larg nga këta dy burra të cilët po ndiqnin njeri tjetrin. Megjithatë, ai pranoi se ai i tha policisë se kishte qenë 10-15 metra larg. Ai deklaroi se nuk mban mend se sa qëndroi në veturën e tij kur u ndal por se deklaroi se ai u nis sapo këta burra shkuan në drejtim të

rrugës për në Banjë. G.B. deklaroi përsëri se ai nuk vuri re këta dy burra por se ai ia shkeli me veturë dhe vazhdoi rrugën e tij për në Pejë.

Prokurori ia përkujtoi G.B. se ai kishte njoftuar policinë, *“pas pak sekondave, unë ia dola të tejkaloj këta njerëz me veturën time dhe të shtënat vazhdonin, por se nuk jam i sigurt se kush po shtinte në kë sepse kisha frik të shikoja, prandaj, sa i përket të dytit, madje nuk jam i sigurt nëse ai kishte diçka në dorë a jo. Pastaj kur arrita afër pikës së karburantit tek udhëkryqi, burrat në fjalë tani ishin ca prapa meje larg. Kështu që unë përsëri u ndala me veturën time tek pjesa e parkingut të pikës së karburantit sepse kisha frikë se po më godiste ndonjë plumb, sepse këta dy burrat që po vraponin ishin mu në mes të autostradës.”* G.B. deklaroi se kjo ishte e vërtet.

G.B. deklaroi se nuk i kujtohet nëse kishte vu re ndokënd nën pemën e arrës në anën e kundërt të pikës së karburantit. Prokurori ia përkujtoi atij se në deklaratën e tij dhënë në polici ai tha se kishte vu re një person që ishte ngjitur në pemë të arrës dhe G.B. u pajtua se kështu ishte.

Prokurori po ashtu ia përkujtoi G.B. se në deklaratën e tij dhënë në polici ai tha, *“Vura re dy persona duke vrapsuar në autostradë, njëri pas tjetrit, në drejtim të udhëkryqit të Banjës, në drejtim të Pejës, unë nuk e dija se kush ishin këta njerëz, por më kujtohet se personi i parë i cili dukej se po ikte ishte rreth 20 vjeç dhe kishte flokë të gjata deri në shpatulla, ndërsa personi i dytë që ishte prapa dukej se po ndiqte personin e parë dhe më kujtohet se kishte të veshur veshje të shkurta deri në gjunjë; pantallona të shkurta. Dhe largësia mes të parit dhe të dytit ishte 10-15 metra”.* G.B. u pajtua se kjo ishte kështu.

Në përgjigjen e tij për pyetjen e avokatit mbrojtës, G.B. u pajtua se në mëngjesin në fjalë ai kishte vu re se që të dy burrat po mbanin armë. Avokati mbrojtës pastaj ia përkujtoi atij se në deklaratën e dhënë në polici ai tha se nuk i kujtohej nëse personi dytë që po e ndiqte personin e parë kishte ndonjë gjë në dorë. G.B. u përgjigj se nuk mbante mend se çfarë kishte deklaruar në deklaratën e tij të parë. Ai po ashtu deklaroi se nuk mund të shpjegonte se përse i ishte referuar shtëpisë së J.O. në deklaratën e tij në polici sepse në atë kohë ai nuk e dinte se kush ishte J.O. dhe se ku gjendej shtëpia e tij.

Avokati mbrojtës po ashtu ia përkujtoi G.B. se në deponimin e tij dhënë këtij trupi gjykues ai deklaroi se largësia mes këtyre dy personave ishte 30 metra ndërsa në deklaratën e tij ai tha se kjo largësi ishte përafërsisht 10-15 metra. G.B. deklaroi se versioni më i saktë ishte ajo që ai ka thënë përpara kur ka dhënë deklaratën. Ai deklaroi se kjo largësi ishte e saktë sa i përket largësisë mes tij dhe personave që ndiqnin njeri tjetrin.

Duke iu përgjigjur kryetares së trupit gjykues, G.B. deklaroi se nuk mund ta rikujtonte se a ishte e njëjta largësi mes burrit të parë dhe të dytë kur ata po vraponin njëri pas tjetrit dhe po shtënin. Ai po ashtu deklaroi se nuk mbante mend se kush shtiu i pari.

Kryetarja i trupit gjykues pastaj ia përkujtoi atij paragrafin në vijim në deklaratën e tij në polici, pra dëshmitarit G.B.: *“kalova pran shtëpisë së J.O.t që ishte rreth 10-15 nga personi i dytë i cili po vraponte. Kur arrita tek rruga e fshatit Kashice, unë pashë burrin e parë me pistoletë të shkurtër në dorën e tij të djathtë drejtuar burrit të dytë, në mënyrë të pakontrolluar, sepse ai po vraponte. Papritmas unë dëgjova një të shtënë nga arma e*

zjarrit”. G.B. u pajtua që kishte thënë kështu por deklaroi se nuk mund të thoshte me siguri nëse personi i parë kishte pistoletë të shkurtër.

Kryetarja e trupit gjykues pastaj ia përkujtoi G.B. se ai po ashtu tha në mënyrë specifike në deklaratën e tij se ai pa se burri i parë ia kishte vu në shënjestër burrin e dytë dhe pastaj ai dëgjoji të shtënë e dytë. Avokati mbrojtës ndërhyri këtu dhe deklaroi se kishte mospërputhje në deklaratën e përkthyer dhe në origjinal nuk është përdorur fjala shqipe për *“shënjestër”* por se është thënë *“dora e djathtë ishte drejtuar drejt personit të dytë në mënyrë të pa kontrolluar”*. Mbrojtja parashtroi se dallimi ishte domethënës.

Me pajtimin e avokatit mbrojtës, kryetarja e trupit gjykues një pjesë të rëndësishme të deklaratës e lexoi me zë dhe u përkthye nga përkthyesi i gjykatës pas së cilës prokurori ra dakord me atë që parashtroi avokati mbrojtës. Kryetarja e trupit gjykues e pyeti G.B. nëse kur ai tha se mbante mend se vuri re që burri i parë drejtoi apo vuri në shënjestër apo ia drejtoi të shtënat burrit të dytë, se a i kujtohet sot ndonjë e shtënë me armë zjarri para lëvizjes së dorës së djathtë të burrit të parë, por se G.B. tha se nuk mund ta mbante mend.

Kryetarja e trupit gjykues po ashtu ia përkujtoi G.B. se ai kishte deklaruar në polici, *“Unë më tej shtoj se kur filluan të shtënat, unë ia dola të tejkaloj këta njerëz në disa sekonda; të shtënat vazhdonin të shkrepeshin”* dhe e pyeti atë nëse i kujtohet atij që i tejkaloj këta njerëz, por se G.B. deklaroi se kjo nuk i kujtohej sot. G.B. deklaroi se motra e tij nuk ka pa asgjë në mëngjesin në fjalë sepse ai ia vuri dorën asaj mbi koke dhe e përkuli atë.

G.B. deklaroi se nuk i kujtohej nëse lëvizja e burrit të parë ishte e njëjtë gjithë kohës apo se ai ndryshoi sjellje gjatë të shtënave gjersa kishte në dorë pistoletën.

G.B. deklaroi se nuk mund të identifikoi burrin e ulur në pemën e arrës me emër. Ai konfirmoi se nënshkrimi në fund të deklaratës në polici i datës 1 Shtator 2006 ishte i tij dhe se përgjithësisht kujtesa e tij ishte më e mirë atëherë se sa tani.

G.B. deklaroi se skica e bashkangjitur kësaj deklarate ishte vizatuar nga oficeri i policisë por se ai ka folur me oficerin e policisë lidhur me incidentin dhe ai vizatonte skicën dhe se ishte përdorur si orientim për diskutimin e tyre.

I pandehuri K.H. pyeti nëse ka qenë e mundur që oficeri i policisë i cili e kishte vizatuar skicën po ashtu t'i ketë treguar dëshmitarit, G.B. lokacionin e shtëpisë së J.O. por se G.B. e mohoi këtë gjë.

G.B. deklaroi se kur të udhëtosh nga Peja për në Istog, shtëpia e J.O. do jetë në anën e majtë. Ai deklaroi se nuk mund të mbante mend largësinë mes shtëpisë së J.O. dhe rrugës kryesore.

G.B. deklaroi se policia nuk i ka paraqitur atij set me fotografi me qëllim të identifikimit.

Në kërkesën e kryetares së trupit gjykues dëshmitari G.B. pastaj (disi me gjysmë zemre) shikoj 16 fotografit e nxjerra nga policia por ai deklaroi se

nuk mund të identifikonte asnjërin nga ta. Dëshmitarit pastaj iu treguan skica më të hollësishme të vendit të ngjarjes dhe iu kërkua të nënvizonte se ku ai pa këta burra duke vrapuar, por ai tha se këtë gjë ai nuk mund ta bënte përpos të thoshte se ata vraponin në rrugën kryesore.

Pala e dëmtuar/dëshmitari Sa.O. dha dëshmi para këtij trupi gjykues me datë 24 Shtator 2014. Ai po ashtu dha deklaratë në prokurori me datë 30 Gusht 2006.

Ai deklaroi se natën para mëngjesit kur ndodhi ky incident ai ishte në Zllakuqan duke ngrënë darkë me të ndjerin J.O.. Pas darkës ata shkuan tek shtëpia e tij (Sa.) ku ndenjën deri afërsisht në mesnatë ku së bashku me L.O., të birin e Jakupit, ai shkoi tek shtëpia e J.O. me motoçikletë. J.O. mbeti tek shtëpia e Sa.O..

Sa.O. deklaroi se para se të arrinin atje ata u takuan me “kriminelët nga Shqipëria”.

Ai deklaroi se ishin për afërsisht larg 20 metra nga shtëpia e J.O. prapa shtëpisë. Ai deklaroi se ishin dy veta dhe se po shkonin zvarrë nëpër tokë këmba dorës si lepuj.

Sa.O. deklaroi se L.O. iu ofrua këtyre dy meshkujve dhe foli me ta. L.O. i pyeti ‘a erdhët për të vjedhur a jeni hajna’.

Sa.O. deklaroi se meshkujt iu përgjigjen ata i tha se ata ishin “punëtorët e S.”

dhe “ne nuk dinin kah të shkonim, ne erdhëm këtu për strehim”.

Sa.O. deklaroi se ai e kuptoi atë si referim për S.K.. Ai deklaroi se këta burra po ashtu than se ishin sjell këtu me një minibus. Sa.O. deklaroi se këta burrat pastaj filluan të ecnin rrugës dhe dolën para shtëpisë. Ai deklaroi se ai L.O. po ecnin pran tyre dhe i pyesnin se përse ishin aty.

Sa.O. deklaroi se ata i pyeten ata se nga ishin dhe se ata u përgjigjen se ishin nga Shqipëria. Ai deklaroi se K.H. pastaj nxori pasaportën dhe e ua tregoi.

Sa.O. deklaroi se A.K. filloi të vraponte. Ai deklaroi se ai e dinte që burri ishte A.K. sepse A.K. ishte dorëzuar në polici atë natë dhe se ai kishte folur me K.H., A. nuk fliste.

Sa.O. deklaroi se K.H. po ashtu iku dhe se ishte në momentin kur ai i telefonoi J.O. dhe i tha se ishin njerëz nga Shqipëria prapa shtëpisë së tij.

Sa.O. deklaroi se për afërsisht pas dhjet minutave J.O. erdhi me A.K. të cilin ia kishte dal ta kapte rrugës.

Sa.O. deklaroi se pastaj J. thirri policinë e cila arriti për afërsisht pas tridhjetë minutave. Në ndërkohë, ai deklaroi se dikush e ngriti mundësi e kontaktimit të S.K.t për të konfirmuar identitetin e dy burrave por se kjo gjë nuk u bë.

Sa.O. deklaroi se nuk i kujtohet të ketë parë këta burra në posedim të armëve. Ai deklaroi se kur arriti policia ata kapën A.K.. Ai deklaroi se S.O.

dhe L.O. po ashtu ishin të pranishëm.

Sa.O. tha se ai dha deklaratë në polici në stacionin policor të Istogut. Ai deklaroi se nuk u kthye në shtëpi por se e kaloi natën në shtëpinë J.O.. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se ku ishte në atë kohë i pandehuri.

Sa.O. deklaroi se ai vetë, S.O. dhe tani i ndjeri J.O. qëndruan në shtëpi së bashku deri për afërsisht në orën 05:45 minuta. Ai deklaroi se ai kishte qenë fjetur kur atë e zgjoi Sa.O.. Ajo e njoftoi atë se kishte dëgjuar të shtëna nga jashtë dhe se “dikush e vrau J.”.

Sa.O. deklaroi se me të dëgjuar këtë gjë ai doli në rrugë të shoh se çka kishte ndodhur. Ai deklaroi se ishte vetëm. Ai tha se tani më ishte mëngjes, ishte ndriçuar dhe se ai mundte të shihte qartë.

Sa.O. deklaroi se ai shkoi në drejtim të Pejës. Kur arriti në rrugën e Kashices, ai mundi të shoh se një person ishte i rrëzuar aty dhe se ai shkoi drejt aty. Ai deklaroi se J.O. ishte pavetëdije. Ai tha se ishin disa vetura që po lëviznin në rrugë.

Sa.O. deklaroi se ai vazhdoi në rrugë dhe se detyroi një vozitës që të hynte në veturën e tij dhe pastaj dërgoi J.O. për në spital të Pejës. Ai deklaroi se ishte vetëm.

Sa.O. deklaroi kur ai fillimisht u ndesh me te, K.H. kishte një shami me ngjyrë të bardhë dhe të zezë të lidhur rreth kokës dhe se kishte flokë të gjata. Ai tha se K.H. ishte dukshëm më i ri se sa A.K..

Sa.O. deklaroi se ai ishte kthyer nga stacioni i policisë së Istokut së bashku me J.O.. Ata kishin diskutuar se besonin që A.K. dhe K.H. kishin ardhur për të vjedhur motoçikletat.

Sa.O. deklaroi se me sa e dinte ai J.O. kishte dy armë gjuetie në shtëpinë e tij dhe se për të dyja ai mbante leje. Ai deklaroi se ai nuk e dinte nëse ai mbante ndonjë armë pa leje.

Në përgjigjen e tij nga avokati mbrojtës, M.R., Sa.O. konfirmoi se ai arriti në shtëpinë e J.O. në mesnatë dhe se J.O. mbeti aty.

Sa.O. deklaroi se ai ia kishte dëgjuar emrin e S.K. por se asnjëherë nuk kishte pasur kontakt të drejt për drejt me te.

Sa.O. deklaroi se ai ishte zgjuar, kishte dal jashtë dhe se kishte shkuar tek udhëkryqi i rrugës Peja/Kashtice ku kishte parë personat në rrugë duke shkuar në punë. Ai nuk kishte parë ndokënd në veçanti. Ai mohoi të mbante mend nëse dëshmitari G.L. ishte i pranishëm.

Avokati mbrojtës, M.R. ia përkujtoi dëshmitarit se në faqen 11 të deklaratës së tij dhënë para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të Pejës të asaj kohe, me datën 15 Tetor 2007 ai kishte thënë *“kur unë dola aty unë pashë nga largësia tek pika e karburantit një person, ai është G.L., dhe ai ma bëri me dorë, dhe unë vazhdova dhe vura re xhaxhain tim të shtrirë me shpinë për toke.”* Sa.O. deklaroi se incidenti kishte ndodhur para tetë viteve dhe se tani nuk i kujtohet.

Avokati mbrojtës, M.R. i përkujtoi dëshmitarit se në deklaratën e tij në prokurori me datë 30 Gusht 2006 ai deklaroi se kur iu afrua shtëpisë së J.O. me motoçikletë me L.O. ai vuri re hije në një largësi prej 200 metrave.

Në përgjigjen e tij Sa.O. deklaroi se kjo nuk ishte e vërtet dhe se në fakt nuk ishte e pamundur që nga automjeti në lëvizje në atë largësi në veçanti në errësirë. Ai deklaroi se kishte menduar që kishte parë lepuj.

Në përgjigjen e mëtejme nga prokurori, dëshmitari përsëriti se atij nuk i kujtohej se a e kishte parë dëshmitarin G.L.. Megjithatë, ai deklaroi se ai e njihte atë më përpara ngjarjeve të mëngjesit në fjalë.

Sa.O. deklaroi se e e pyeti atë nëse kishte parë ndonjë atë mëngjes por se G.L. deklaroi se kur “ne” dëgjuaam të shtënat “ne” u futem nën veturë.

Sa.O. deklaroi se G.L. nuk kishte thënë se kush shkrepiti të shtënat. Në përgjigjen e tij ndaj pyetjes së parashtruar nga gjyqtari Arben Mustafa, Sa.O. deklaroi se nuk i kujtohej se kush e thirri policin atë natë. Ai konfirmoi dëshminë e tij të mëhershme se A.K. është marr nga oborri.

Sa.O. po ashtu deklaroi se kur arriti tek i rrëzuari J.O. aty ishte një armë afër tij por se nuk e di se a ishte armë me tytë të gjatë apo të shkurtër.

Në këtë moment, avokati mbrojtës M.R. vuri në pah se në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor të Gjykatës së Qarkut të Pejës të asaj kohe me datë 15 Tetor 2007, në faqen 11, dëshmitari kishte deklaruar *“në vendin e ngjarjes afër dorës së djathtë të xhaxhait tim, vura re një armë e që ishte një*

revolver.”

Sa.O. deklaroi se ai kishte thënë këtë te vendi i ngjarjes dhe tani dëshiron të thotë se arma ishte te dora te trupi. Ai deklaroi se ai e pa armën aty por se nuk e kishte prekur. Ai deklaroi se trupi ishte në tokë me dorën e djathtë të shtrirë dhe se arma ishte afro gjysmë metri më tutje nga dora prapakokës.

Sa.O. deklaroi se ai nuk kishte qenë në ushtri dhe se nuk dinte dallimin mes armës me tytë të gjatë dhe të shkurt. Megjithatë, ai deklaroi se pa një plagë në trup, *“në ballë në mes të syve”*.

Në përgjigjen e tij në pyetjen nga i pandehuri, K.H., Sa.O. deklaroi se ai ishte me A.K. dhe K.H. deri sa ata ia mbathen. Ai deklaroi se ai ishte i pranishëm me J.O., djalin e tij L. dhe anëtarët e tjerë të familjes O..

Fillimisht, dëshmitari ekspert **Ç.H.** dha dëshmi në shqyrtimin kryesor me datë 31 Korrik 2014. Me datë 7 Nëntor 2014 ai është përkujtuar që të sqaroj pjesë nga dëshmia e tij.

Në deklaratën e tij të datës 31 Korrik 2014 dëshmitari ekspert Ç.H. deklaroi se ai e pranoi rastin me datën 26 Nëntor 2006.

Ai deklaroi se iu dha numri referues Nr. 2006-DI352 dhe kërkesa e Gjykatës së Qarkut u emërtua kërkesa Nr. PPQ Nr. 83/06. Ai deklaroi se Njësitit i tij pranoi 7 prova materiale tërësisht.

Ai deklaroi se prova e parë materiale ishte një armë automatike AK-47 i kalibrit 7.62 mm, me numër serik 14189429 dhe e cila ishte e prodhuar në Kinë.

Ai deklaroi se prova e dytë materiale e dy karikatorëve lidhej me provën e parë materiale, që të dyja të kalibrit 7.62x39 mm bashkë me 59 fishek të të njëjtit kalibër. Ai deklaroi se të 29 fishekët kishin shenjë apo ishin të shënjuar me PPY me shkronja cirilike, dhe të 24 fishekët kishin numrat 10-99 dhe 3 fishek kishin shenjën 31-67.

Ai deklaroi se prova e tretë materiale ishte një pistoletë “Crvena Zastava” modeli 57 e kalibrit 7.62x25 mm që mbante numrin serik F-203418 dhe e cila ishte e prodhuar në Jugosllavi.

Ai deklaroi se prova e katërt materiale lidhet me karikatorin e provës së tretë materiale dhe 8 fishekëve të kalibrit 7.62x25 mm.

Ai deklaroi se prova materiale e pestë ishte një pistoletë “Sig Sauer” modeli P201, 9.19 mm me numër serik 193540 dhe një karikator i pistoletës. Arma ishte prodhim Zviceran.

Ai deklaroi se prova e gjashtë materiale ishte një pistoletë Glock, modeli 19, kalibri 9.19 mm, me numër serik nr. CNB 406 dhe një karikator për këtë armë. Kjo armë është prodhuar në Austri.

Ai deklaroi se prova e shtatë materiale ishin 19 gëzhoja, të kalibrit 9.19 mm, 12 fishek, 5 plumba GFM Luger, dhe 2 plumba RËS- 9 mm-Luger.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se armët (AK-47, pistoleta Crvena Zastava (CZ) M57 dhe Sig Sauer B210 dhe Glock model 19 janë testuar dhe ishin funksionale. Ai deklaroi se mostrat e armëve janë krahasuar apo përshtat me gëzhojat që ai ka marr. Ai deklaroi se rezultatet e testeve ku gëzhojat janë shkrepur nda të dy armët, 12 gëzhoja janë shkrepur nga prova materiale Nr. 6 dhe 7 plumba janë shkrepur nga prova materiale Nr. 5.

Ai deklaroi se ai u konsultua me bazën e të dhënave të njësimit të tij për të vërtetuar nëse këto armë janë përdorur në raste të tjera, por se nuk është gjetur asnjë përputhje.

Në përgjigjen të pyetjes të parashtruar nga kryetarja e trupit gjykues, dëshmitari ekspert Ç.H. deklaroi se ai ishte ekspert i trajnuar i balistikës dhe se për këtë rast ai vetë i kishte testuar armët. Ai përshkroi testet standarde të zbatuara nga njësiti i tij kur ata marrin një armë zjarri. Ai deklaroi se në këtë rast të gjitha pjesët ishin origjinale dhe se asnjë pjesë nuk ishte ndërruar.

Dëshmitari ekspert Ç.H. deklaroi se oficerët e Policisë së Kosovës mbledhin dhe bartin provat materiale në laboratorin e tij. Ai deklaroi se ekspertët e vendit të ngjarjes kanë një listë në të cilën ata shënojnë gjerat e provave, vendin se ku janë gjetur, si janë lëvizur etj.

Dëshmitari ekspert deklaroi se në këtë rast ai ishte njoftuar thjesht për emrat e plotë të personave se kush ishte viktimë dhe i dyshuar por pa ndonjë hollësi tjetër.

Avokati mbrojtës, M.R. pyeti se përse armët u pranuan me datë 22 Shtator

2006 gjersa ekzaminimi i tyre nuk u bë deri me datën 20 Nëntor 2006 (d,m.th. një vonesë prej dy muajve)? Dëshmitari ekspert Ç.H. u përgjigj se njësitit i tij është shumë i ngarkuar dhe se duhet kohë për të kryer teste standarde dhe të veçanta për të gjitha armët që pranohen. Megjithatë, dëshmitari deklaroi se këto vonesa nuk ndikojnë në gjurmët e dëshmimeve që mund të zbulohen në armë.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se ai nuk gjeti asnjë provë të shenjave të gishtërinjve nga armët. Ai deklaroi se këtë e bëri M.A..

Dëshmitari ekspert Ç.H. deklaroi se karikatori i pistoletës Glock pistol mund të mbaj pesëmbëdhjetë (15) plumba, ndërsa Sig Sauer mund të mbaj tetë (8). Ai deklaroi se këto dy armë kishin karikator të zbrazet kur ato u pranuan nga njësitit i tij.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se pistoletat Glock dhe Sig Sauer ishin që të dyja të të njëjtit kalibër, që do të thotë 9x19mm.

Pastaj prokurori pyeti dëshmitarin se çfarë metode është zbatuar për të vërtetuar se 12 gëzhojat ishin të shkrepura nga Glock-u dhe se 7 gëzhojat ishin të shkrepura nga Sig Sauer? Dëshmitari ekspert deklaroi se së pari janë krahasuar kalibrat (e që të dyjave ishin 9x19mm) para se të krahasoheshin veçorit tjera të përgjithshme. Ai deklaroi se në të shumtën e rasteve tek armët janë pesë (5) veçorit të përgjithshme, që do të thotë gjilpëra e gjuajtjes, qitësi, hedhësi, pjesa ballore e folesë së plumbit si dhe shenjat e tytës. Ai deklaroi se secila armë përmban këto karakteristika por se asnjë armë nuk i ka të njëjta këto karakteristika.

Në përgjigje të pyetjes së prokurorit dëshmitari konfirmoi se në bazë të krahasimit të këtyre pesë (5) veçorive ai erdhi në përfundim se të dymbëdhjetë (12) gëzhojat ishin të plumbave të shkrepur nga “Glock” dhe shtatë (7) ishin të shkrepura nga “Sig Sauer”. Ai deklaroi se për këtë nuk kishte dyshime.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. më pas iu përkujtua se me datë 7 Nëntor 2014 të sqaronte aspekte të caktuara të dëshmisë së tij.

Gjatë ekzaminimit pasues, mbrojtja e të pandehurit K.H., avokati M.R. ia përkujtoi dëshmitarit ekspert Ç.H. se dëshmia e dëshmitarit ekspert, Dr. A.G. ishte se viktima pësoi lëndimin e parë gjersa ishte në pozitën këmbë ndërsa plagën e dytë e morri kur ishte në pozitë të përkulur çka është argumentuar nga trajektorja e plumbit dhe se këto dy konkluzione e quan atë të besoj se të shtënat u shkrepën nga një largësi më e madhe se një (1) metër. Mbrojta pyeti dëshmitarin ekspert, Ç.H. se a pajtohej me këtë gjë? Megjithatë, dëshmitari deklaroi se nuk ishte në kornizën e ekspertizës së tij të ofroj një mendim për këtë.

Në përgjigje të pyetjes së trupit gjykues dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se pistoletat Sig Sauer mund të mbaj tetë (8) fishekë ndërsa Glock model 19 mund të mbaj pesëmbëdhjetë (15).

Kryetarja e trupit gjykues pyeti dëshmitarin ekspert nëse i kujtohet se kur i ekzaminoj këto dy armë dhe nëse kishte mbetur ndonjë plumb a jo në karikatorë në atë kohë?

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se nuk mbante mend se kur kishte bërë ekzaminimet përpos se ishte në vitin 2006. Megjithatë, nga shënimet e tija dhe ato të oficerit që i dërgoi armët në njësitin e tij për ekzaminim ai mund të konkludoj se karikatorët veç ishin hequr dhe se ishin të zbrazëta kur ato u pranuan.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se pistoleta “Glock” ishte Glock 19 dhe jo Glock 17.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se faktori më i rëndësishëm dallues lidhur me secilën armë është numri i saj serik. Ai deklaroi se secila armë ka numër të ndryshëm serik.

Dëshmitari ekspert Ç.H. konfirmoi se prova materiale nr. 6 ishte pistoleta “Glock”. Ai deklaroi se duket të përcaktohet me të njëjtin numër të provës materiale ashtu siç ishte përcaktuar kur është marr në vendin e ngjarjes. Megjithatë, ai nuk mund të thoshte se kjo do të ketë ndodhur në vitin 2006. Ai deklaroi se kjo do varej nga regjioni dhe njësitin.

Trupi gjykues pyeti dëshmitarin ekspert Ç.H. lidhur me armen e cila u gjet pas incidentit në drejtimin e të pandehurit K.H.. Dëshmitari deklaroi se kjo po ashtu është ruajtur.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se nëntëmbëdhjetë gëzhojat (19) u krahasuan me qëllim të vërtetimit se a ishin zbrazur nga e njëjta armë. Ai deklaroi se u zbulua se dymbëdhjetë (12) gëzhojat janë zbraz nga e njëjta armë, ndërsa shtatë (7) dolën nga arma tjetër. Ai deklaroi se dymbëdhjetë

(12) gëzhojat u zbrazen nga “Glock” model 19, ndërsa shtatë gëzhojat tjera (7) u shkrepën nga “Sig Sauer”. Ai deklaroi se kjo u bë duke krahasuar gëzhojat nën mikroskop dhe duke krahasuar karakteristikat e tyre. Ai më pas përshkroi këto karakteristika në kuptimin e përgjithshëm.

Kryetarja e trupit gjykues pastaj ia përkujtoi dëshmitarit ekspert se në raportin e vendit të ngjarjes është përmendur “Glock” 17. Dëshmitari, Ç.H. deklaroi se autori i këtij raporti është në gjendje që të sqaroj këtë më së miri. Ai konfirmoi “Glock” model 19 ashtu si dhe “Sig Sauer” ishin të të njëjtit kalibër.

Dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se me sa e di ai armët u ekzaminuan për shenja të gishtërinjve por se nga një sektor tjetër i njësitit por se ai vetë rrallë se është i përfshirë në atë proces.

Në përgjigje të pyetjes së avokatit mbrojtës M.R., dëshmitari ekspert, Ç.H. deklaroi se asnjë plumb që është gjetur në trupin e viktimës i është dërguar më pas atij.

Fillimisht, dëshmitari ekspert **Dr. A.G.** dha dëshmi në shqyrtimin kryesor me datë 1 Gusht 2014. Me datë 24 Tetor dhe 9 Dhjetor 2014 ai u rikujtua që të sqaronte aspekte nga dëshmia e tij.

Dëshmitari ekspert Dr. A.G. nënvizoi biografin e tij arsimore dhe deklaroi se qysh nga viti 1995 ai ishte asistent i profesorit në fushën e mjekësisë

ligjore dhe që nga viti 1999, ai ishte kryetar i ish Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe se tani është Kryetar i Departamentit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.

Në fillim, dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se opinioni i tij për këtë rast mundet vetëm të bazohet në fletë-lëshimin e siguruar nga Spitali i Universitetit të Prishtinës dhe pa llogarit trajtimin e të ndjerit, J.O. që ai e mori në Zvicër. Ai deklaroi se fletë-lëshimi nuk ishte raport mjekësor dhe nuk përmban të gjitha elementet e domosdoshme për të dhënë një mendim dhe atij do i duhej të shihte raportin e autopsisë. Kryetarja e trupit gjykues sqaroi se përpjekjet për të siguruar këtë nga autoritetet Zvicerane ishin në progres e sipër.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. u paraqit përsëri para trupit gjykues të shqyrtimit kryesor për të dhënë dëshmi me datë 24 Tetor 2014. Para nisjes së seancës ai ishte furnizuar me raport të autopsisë lidhur me të ndjerin J.O. të pranuar nga autoritetet Zvicerane.

Në bazë të fletë-lëshimit nga Spitali i Universitetit të Prishtinës dhe raportit të autopsisë, dëshmitari ekspert Dr. A.G. deklaroi se i ndjeri Ztr. J.O. u pranua në Spitalin e Universitetit të Prishtinës me datë 20 Gusht 2006 dhe është lëshuar me datë 21 Gusht 2006. Gjatë kësaj kohe ai iu nënshtrua një operacioni në kokë për të shëruar plagën e shkaktuar nga arma e zjarrit. Copëza të vogla të metalit iu hoqën nga koka. Po ashtu u shënua se J.O. kishte pësuar një tjetër plagë në shpatullën e majtë. Ai u lëshua nga Spitali i Universitetit të Prishtinës me datë 21 Gusht 2006 dhe u transferua në spitalin e Lausannes në Zvicër.

Dëshmitari ekspert Dr. A.G. deklaroi se raporti i autopsisë tregonte se J.O. kishte pësuar një plagë në anën e djathtë të kokës 10 cm nga vetulla dhe deri në 12cm më tej nga niveli i veshit të djathtë. Kjo ishte qepur me pe kirurgjik. Ai deklaroi se një pjesë e kockës së kafkës mungonte e që ai deklaroi konsistonte me intervenimin kirurgjik.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se autopsia shënonte se një pjesë e masës së trurit mungonte dhe ishte një regjion që përmbante gjak. Në masën e dëmtuar të trurit, u gjeten dy copëza të vogla të metalit dhe këto ishin copëza të plumbit të dëmtuar.

Dëshmitari ekspert Dr. A.G. deklaroi se për shkak të ndikimit në kockë, plumbi u copëtua në pjesë të vogla dhe u grumbullua në masën e trurit në anën e djathtë. Si rezultat i kësaj nuk pati plagë dalëse. Kjo do të thotë se ne nuk kemi plagë dalëse. Ai deklaroi se kjo përkonte me operacionin e kryer në Spitalin e Universitetit të Prishtinës ku janë hequr disa copëza të vogla metali, por se dy mbeten për shkak se kirurget nuk ishin në gjendje të shkonin më thellë në tru.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se doktori që bëri autopsinë në Zvicër nuk mundi të identifikonte ndonjë mbetje nga e shtëna me armë në trupin e të ndjerit (nuk pati ndonjë ngjasim tipik si “tatuazh”) prandaj ishte e pamundur të thuhej se nga çfarë largësie është shkrepur secila e shtënë.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se raporti i autopsisë përshkruante plagën e dytë në shpatullën e viktimës me ç’ rast i është thyer kocka e krahut dhe i janë dëmtuar muskujt regjional. Megjithatë, ai deklaroi se kjo plagë

dëmtoi organet jo vitale andaj nuk ishte vdekjeprurëse. Ndryshe kjo plagë kishte piken hyrëse dhe dalëse.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. se ai mund të pohonte me “*siguri të lart*” se natyra e plagëve hyrëse dhe dalëse tregonin se viktimi ishte në pozitë të përkulur, kur ai pësoi plagën e dytë. Dëshmitari deklaroi se nuk pati gjurmë të alkoolit në analizat toksikologjike.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se plaga në kokë është shkaktuar nga ana e djathtë e përparme., ndërsa plaga në shpatull erdhi nga pjesa e përparme nga ana e majtë në pjesën e pasme dhe teposhtë.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se plaga në kokë ishte ajo e cila përfundimisht shkaktoi vdekjen sepse truri është organ vital i cili me këtë rast ishte atakuar.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se plaga nga e shtëna me armë në kokë do ta ketë paaftësuar të ndjerin dhe se ai nuk ka mundur të vazhdonte të vraponte pasi që e ka pësuar të njëjtën.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se i ndjeri ishte në gjendje kome kur është lëshuar nga Spitali i Universitetit të Prishtinës.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. deklaroi se nga natyra e plagës ai nuk mund të thotë largësinë nga e cila është qëlluar viktimi.

Në përgjigje të pyetjes së avokatit mbrojtës M.R., dëshmitari ekspert Dr.

A.G. konfirmoi se i ndjeri ishte i gjatë 185cm. Ai deklaroi se nuk mund të deklaronte nëse person që shtiu në te ishte më i gjatë se ai.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. përsëriti se operacioni i kryer në Prishtinë pasoi me heqjen e disa copëzave të metalit nga truri i viktimës por se copëza të tjera kishin ngecur aq thellë sa që kirurgët në Zvicër nuk mundën t'i largonin ato.

Avokati mbrojtës pastaj ka tentuar që t'i bën pyetje dëshmitarit ekspert duke u bazuar në përmbajtjen e deklaratës së dëshmitarit tjetër por trupi gjykues ka vendosur se kjo do të mund të bëhet vetëm po qe se dëshmitari ekspert shqyrton një numër të deklaratave të dëshmitarëve e jo vetëm një deklaratë.

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. ka deklaruar se ka pasur gjasa që të shtënat janë bërë të një pas njëshme dhe plaga në kokë është shkaktuar së pari dhe pastaj kanë pasuar plagët në kraharor.

Dëshmitari, **Dr. A.G.** është shfaqur përsëri para trupit gjykues për të dhënë dëshmi më 9 dhjetor 2014. Dëshmitari ekspert i është përgjigjur pyetjeve të cilat i ka pranuar me shkrim nga trupi gjykues dhe nga avokati mbrojtës para kësaj seancë. Dëshmitarit ekspert i janë dhënë kopjet e deklaratave të dëshmitarëve kyç në këtë rast. Prokurorit gjithashtu i është dhënë mundësia për t'i rishikuar këto pyetje para se me iu dorëzuar doktorit por ai ka refuzuar. Trupi gjykues gjithashtu i ofroi Prokurorit mundësinë që t'i parashtrojë pyetje me shkrim dëshmitarit ekspert, por ai nuk dëshiroi ta bënte këtë.

Në përgjigjen në pyetjen e parë që është parashtruar nga avokati mbrojtës, “A ka mundësi që i pandehuri e ka plagosur viktimën duke ikur nga viktima, i cili ishte duke shtënë drejt tij?”, dëshmitari ekspert, Dr. A.G. është përgjigje, Po, por gjithashtu është e mundur që i pandehuri e ka qëlluar viktimën kur është ballafaquar drejtpërdrejt me të.

Në përgjigjen në pyetjen e dytë, “Si e vlerëson eksperti, se në çfarë distance ishin këto dy të shtëna nga e cila i ndjeri ka marrë plagët dhe cila prej tyre ishte fatale”? dëshmitari ekspert është përgjigje që intervali kohor në mes të shtënave ishte i shkurtër dhe e shtëna e parë ishte fatale.

Avokati mbrojtës për të pandehurin, K.H. avokati, M.R. ka pyetur nëse kishte të shtëna tjera në mes të shtënave të cilat e kanë shkaktuar plagën fatale në kokë dhe pastaj plagën në kraharor ?

Dëshmitari ekspert, Dr. A.G. ka deklaruar se ma mirë do të kishte qenë po qe do t’ia drejtonte këtë pyetje një eksperti të balistikës dhe se ai as nuk do të mund ta përjashtonte këtë e as ta konfirmonte.

Në përgjigje të pyetjes së trupit gjykues nëse viktima ishte në lëvizje kur ishte shtënë në të, dëshmitari ekspert Dr. A.G. ka deklaruar se asnjëri prej këtyre skenarëve nuk mund të përjashtohet. Ai ka theksuar se në atë momentin kur organet vitale lëndohen në këtë mënyrë, efekti i parë është dezorientimi dhe humbja e vetëdijes dhe kjo do të thotë se viktima ka mundur të qëndronte për një kohë por nuk ka pasur vetëdije.

Në përgjigje të trupit gjykues nëse trupi ishte në lëvizje kur u qëllua për së

dyti viktima, dëshmitari ekspert, Dr. A.G. ka theksuar se do të ishte rrëzuar për shkak të fuqisë së gjuajtjes së dytë.

Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori, dëshmitari ekspert, Dr. A.G. ka theksuar se të shtënat fatale janë gjuajtur nga një distancë prej më shumë se një (1) metër por se ai nuk mund të thoshte saktësisht sa metra.

Dëshmitari, zyrtari i policisë **A.B.** nga Njësia Rajonale e Mjekësisë Ligjore të Policisë së Kosovës në Pejë, ka dhënë dëshmi para trupit gjykues gjatës seancës më 5 shtator 2014. Ai është pyetur në lidhje me raportin për vendin e ngjarjes nr. 26/352 të datës 20 gusht 2006.

Zyrtari A.B. ka theksuar se e ka përpiluar raportin në bashkëpunim me zyrtaret e policisë E.N. dhe B.I.. Ai ka theksuar që së bashku me këta dy oficer e ka kryer inspektimin e vendit të ngjarjes më 19 gusht 2006 pasi që ishin qëlluar me armë J.O. dhe A.B.. Ai ka theksuar se përmbajtja e raportit ishte i saktë.

Oficeri A.B. ka filluar dëshminë e tij duke konfirmuar se as E.N. e as B.I. nuk ishin ende të punësuar në Policinë e Kosovës.

Oficeri A.B. kishte treguar nëntëmbëdhjetë (19) gëzhoja të kalibrit 9 mm ishin gjetur në vendin e ngjarjes. Ai ka dëshmuar se ishte një distancë prej dyqind e pesëdhjetë e dy metra (252m) në mes të gëzhojave të para dhe të dyta. Në skemën e vendit të ngjarjes, të krijuar nga Njësia Rajonale e Mjekësisë Ligjore gëzhoja e parë e cila ishte gjetur i është vënë numri një

(1) dhe gëzhjojës së fundit i është lënë numri njëzet e tre (23). Oficeri A.B. ka konfirmuar se të gjitha gëzhojat ishin të të njëjtit kalibër.

Oficeri A.B. ka theksuar se një pistoletë Sig-Sauer gjithashtu të kalibrit 9 milimetra është gjetur në vendin e ngjarjes. I është caktuar numri tetë (8).

Oficeri A.B. ka dëshmuar se aty kishte ndërtesa në të dyja anët e rrugës dhe një (*qebaptore*) ishte qëlluar nga plumbat gjatë shkëmbimit me armë zjarri. Ai ka theksuar se *qebaptorja* nuk ishte më aty.

Oficeri A.B. ka dëshmuar se është gjetur edhe një armë, jo te ai vend i ngjarjes kur është arrestuar i dyshuari. I dyshuari kishte theksuar se ai e kishte hedhur armën në një përrua të ujit. Kjo armë ishte e llojit *Glock*. Megjithatë, oficeri A.B. nuk e dinte se sa larg nga vendi i ngjarjes ishte gjetur arma e dytë *Glock*.

Oficeri A.B. ka konfirmuar se të gjitha gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes ishin të kalibrit 9mm. Megjithatë, ai ka theksuar se nuk dinte asgjë rreth mostrave të mbetjeve nga të shtënat me armë të marra nga duart e të pandehurit, K.H.. Ai ka theksuar se kjo ishte një çështje që i përkiste laboratorit të mjekësisë ligjore. Ai gjithashtu nuk mund të tregonte se gëzhojat çfarë plumbave i takonin dhe nga cila armë. Sidoqoftë, ai ka theksuar që ekspertet e balistikës nuk mund të përcaktonin këtë.

Oficeri A.B. ka theksuar se kur ai ka arrite në vendin e ngjarjes, trupi i J.O. ishte larguar.

Në përgjigje të pyetjes nga trupi gjykues, oficeri A.B. ka thënë se magazina e pistoletës *Sig-Sauer* ishte e zbrazët kur është gjetur. Ai gjithashtu kishte konfirmuar nga raporti se aty ishin tre plumba në magazinën e armës *Glock* e cila ishte gjetur më larg nga vendi i ngjarjes në drejtim të pandehurit, K.H..

Dëshmitari, oficeri i policisë së Kosovës **A.B.** është thirrë përsëri më 9 dhjetor 2014 për të sqaruar aspektet e dëshmisë ë tij.

Oficeri A.B. ka deklaruar se artikujt në listën e provave me numër rendor prej 1 deri 27 janë përputhur me raportin e inspektimit të vendit të ngjarjes si dhe me raportin nga laboratorit. Sidoqoftë, ai nuk ka mundur të kundërshton prokurorin kur ka vërejtë se janë bërë disa gabime në lidhje me numrat e caktuar për disa artikuj specifik.

Avokati mbrojtës i të pandehurit, K.H. avokati M.R. ka theksuar se i pandehuri vet i ka treguar policisë se ku e ka hedhur pistoletën dhe pistoletën në të vërtetë është gjetur në po atë vend. Ai gjithashtu ka theksuar se testi i balistikës ka treguar se i pandehuri ka shtënë nga ajo armë dhe ai kurrë nuk e ka mohuar këtë.

Dëshmitari, oficeri A.B. ka deklaruar se funksioni i tij në vendin e ngjarjes ishte i kufizuar në detyra si mbajtja e shiritit për matje dhe kolegët e tij, oficerët E.N. dhe B.I. ishin në krye të detyrave.

Si përgjigje në vërejtjen e kryetarit të trupit gjykues në raportin e vendit të ngjarjes që i është referuar pistoletës *Glock* të modelit 17, përderisa raporti i

balistikës i është referuar si pistoleta *Glock* e modelit 19, dëshmitari ka theksuar se ky kundërshtim i dukshëm mund të zgjidhet shumë lehtë.

Oficeri A.B. ka theksuar se në teori sistemi i numërimit i përdorur nga oficerët e policisë në vendin e ngjarjes është dashur të përcillet nga kolegët e tyre në laboratorin e mjekësisë ligjore por oficerët e balistikës mundë të shpjegojnë për çfarëdo mospërputhje.

Oficeri A.B. ka theksuar se zyrtari i policisë E.N. dhe një zyrtar nga hetuesit së bashku me të pandehurin e kanë gjetur armën *Glock* e cila është gjetur jashtë vendit të ngjarjes. Ai ka theksuar se ai nuk mund të tregonte se sa plumba kishin mbetur në magazinë dhe se përse plumbat të cilat kishin mbetur në magazinë nuk ishin aty kur është pranuar arma në laboratorin e mjekësisë ligjore.

Më 24 tetor 2014, trupi gjykues ka dëgjuar dëshminë nga oficeri i policisë së Kosovës **E.B.**.

Oficeri E.B. ka theksuar se i pandehuri dhe arma e tij janë marrë dhe larguar nga vendi i ngjarjes. I dyshuari, K.H. është kapur nga policia në rrugën magjistrale Pejë –Rozhajë në fshatin Novosellë.

Oficeri E.B. ka theksuar se me arrestimin e tij i pandehuri K.H. është dërguar në stacionin policor rajonal në Pejë ku ai ka pranuar se kishte qenë në Banje, se ai kishte qenë i përfshirë në një incident me të shtëna armësh dhe se ai e kishte fshehur armën diku në një fshat të afërt dhe jo shumë larg

nga vendi ku ishte arrestuar. I pandehuri menjëherë më pas i kishte dërguar oficeret në fshatin Radavc ku ai ju kishte treguar një pistoletë të zezë *Glock*, e cili ishte në një kanal nën një urë. I pandehuri, K.H. ka pranuar se e ka përdorë atë armë.

Oficeri E.B. ka theksuar se i pandehuri, K.H. ka theksuar se “*kur kam gjuajtur në drejtim të tij, e kam parë se ai kishte rënë në tokë*” por oficerët nuk e kishin pyetur se kush e ka gjuajtur plumbin e fundit.

Oficeri E.B. ka theksuar se ai i ka parë provat me lokacion në vendin e ngjarjes por njësia e mjekësisë ligjore ishin përgjegjës për bërjen e fotografive dhe evidentimin dhe mbledhjen e provave.

Oficeri E.B. ka konfirmuar se gjetjet e njësisë së mjekësisë ligjore se kryesisht nëntëmbëdhjetë gëzhojat që i takonin plumbave 9mm janë gjetur. Ai gjithashtu ka konfirmuar se nga gjetjet në laboratorin e balistikës në Prishtinë, kryesisht që 12 prej këtyre gëzhojave janë gjuajtur nga arma *Glock*, arma *Glock* dhe 7 vinin nga një *Sig Sauer*.

Oficeri E.B. ka konfirmuar se kur një elementi të provave i është caktuar numri dhe i janë dhënë njësia së balistikës, do të mbante të njëjtin numër.

Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës për të pandehurin, K.H. avokati M.R., Oficeri E.B. ka theksuar se pastaj i dyshuari, K.H. është arrestuar përafërsisht katër orë para incidentit por ai nuk mund të thoshte se e i ka rezistuar arrestit. Ai është dërguar në drejtorinë rajonale në Pejë ku ai ishte bashkëpunues deri në nivelin ku më vonë ai i kishte shoqëruar oficerët

e policisë në vendin ku ishte gjetur arma nën urë.

Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës për të pandehurin, K.H. avokati M.R., oficeri E.B. kishte thënë se i pandehuri kishte deklaruar në deklaratën e tij *“shumë shpesh”*, se si *“ai ishte takuar me një person, ai ishte angazhuar për të kryer një vrasje, dhe se ai ishte me disa miq dhe se një person ishte paraqitur aty, ata kishin pasur disa probleme me të dhe se ata kishin shtënë në njëri tjetrin dhe se ai e kishte gjuajtur atë me armë”*. Oficeri E.B. nuk ka mundur të kujton nëse i pandehuri ka theksuar se kush ka gjuajtur i pari.

Oficeri E.B. ka theksuar se arma *Sig Sauer* e cila ishte gjetur në vendin e ngjarjes është dashur të gjetet me një tytë të hapur d.m.th që magazina ishte plotësisht e zbrazët por ai nuk ishte i sigurtë.

Oficeri E.B. gjithashtu ka theksuar se përgjatë rrugës më poshtë nga stacioni i policisë në Istog, një AK 47 dhe një pistoletë TT është gjetur por nuk është konfirmuar se nuk është gjuajtur me këto.

Provat tjera

Në konkluzion të procedimit të provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 19 janar 2015 palët janë pajtuar se të gjitha deklaratat dhe raportet e përmbajtura në shkresat e lëndës do të pranoheshin si prova dhe të konsideroheshin si të lexuara. Këto kanë përfshirë tre(3) shkresa të lëndës në rastin P. nr. 542/11 kundër të pandehurve Xh.K., S.K. dhe V.K.. Fillimisht ky rast ka përfshirë të pandehurit, K.H. dhe A.K. para se rasti kundër tyre të

ndërpritej nga aktvendimi i gjyqtarit të Gjykatës së Qarkut (në atë kohe) në Pejë, të datës 29 qershor 2012. Rasti “të ri” i është caktuar një numër P. Nr. 267/12. Pas paraqitjes së aktakuzës së ndryshuar e cila i ka tërheqë akuzën e bashkimit kriminal për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë kundër të pandehurit A.K. , ai është liruar nga akuza me aktvendimin e datës 26 shtator 2014. Rasti kundër tij është ndërprerë nga aktvendimi i datës 26 shtator 2014. Këtij rasti “të ri” i është caktuar numri P. nr. 224/14.

iii. Provat e G.L.

Të gjitha palët janë pajtuar se dëshmia e dëshmitarit **G.L.** është relevante . Ai ka dhënë deklaratë në policinë e Kosovës më 20 gusht 2006 dhe në prokurori më 12 shtator 2006.

Në deklaratën tij në policinë e Kosovës më 20 gusht 2006, dëshmitari G.L. ka deklaruar se në orën 05:45 në atë mëngjes, pasi që e kishte mbyllur derën e dyqanit të tij, lokalet me emrin “DINO KOM” të vendosur në kryqëzimin Pejë-Istog-Banjë, “*në një moment*” ai i kishte dëgjuar tri deri në katër të shtëna me armë zjarri. Ai kishte theksuar se menjëherë ishte kthyer dhe kishte shikuar drejt të shtënave dhe në distancë prej afro 15 deri 20 metra ai kishte vërejtur dy persona të cilët ishin duke vrapsur nga drejtimi Istog në Pejë, përgjatë rrugës kryesore Istog- Pejë. Ai kishte deklaruar se të dytë mbanin armë në duart e tyre dhe distanca në mesin e tyre ishte nga 10 deri në 15 metra. Ai kishte theksuar se e njohte personin i cili ishte pak më larg pasi që shtëpia e tij nuk ishte larg punës së tij dhe se ai e dinte se emri i tij ishte J.. G.L. kishte deklaruar se ai e kishte parë J. duke shtënë drejt personit i cili ishte duke vrapsur në drejtimin e Pejës. Ai kishte theksuar se ai kurrë

nuk e kishte parë këtë person më herët dhe se J. kërkonte nga ia që të ndalej. Ai kishte thënë se personi i cili ishte duke vrapuar i ishte përgjigje duke gjuajtur me armë në drejtim të J. dhe ai në të njëjtën kohë vraponte për të ikur. Dëshmitari kishte deklaruar se kur ata i ishin afruar kryqëzimit të rrugës Pejë-Istog-Banjë ai kishte vërejtë *“kur personi i cili ishte duke vrapuar kishte gjuajtur dy apo tri herë me armë dhe në atë çast J. ishte rrëzuar”*. Ai kishte theksuar se personi i cili kishte gjuajtur në drejtim të J. e kishte kaluar rrugën kryesore Pejë/Banjë dhe ai kishte vrapuar në një fushë dhe kishte ikur.

G.L. kishte theksuar se nipi i J. kishte arrite dhe i kishte kërkuar ndihmë atij që ta vendosnin J. në veturë. G.L. kishte thënë se kur ai i ishte afruar J., ai kishte parë armën e cila ishte në dorën e J. dhe se *“tyta e armës kishte mbetur e hapur.”* Ai kishte theksuar se së bashku me nipin e J. dhe S.B.G., i cili punon në pompën e benzinës, e kishin vendosur J. në Opel Vectra dhe e kishin sjellë në spitalin rajonal të Pejës. Ai pastaj e kishte dhënë një përshkrim në detaje të personit i cili kishte shtënë në drejtim të J. dhe kjo përputhej me ate të pandehurit, K.H..

Dëshmitari, **G.L.** ishte intervistuar nga prokurori më 12 shtator 2006 gjatës së cilës intervistë ai përsëri e kishte marrë përshkrimin e personit i cili kishte gjuajtur në drejtim të viktimës J.O.. Ky përshkrim përputhej me përshkrimin e të pandehurit, K.H.. Ai gjithashtu kishte dëshmuar se kur ai i ishte afruar të plagosurit J.O., ai ishte i shtrirë në tokë me shpinë të kthyer, duart ishin poshtë por ai ishte ende i gjallë, ai nuk mund të fliste, ai mund ta dëgjonte atë duke marrë frymë, arma e tij ishte afër dorës së tij dhe se ai e kishte një plagë në kokën e tij dhe se ai kishte edhe një plagë në krahun e tij të majtë.

I vetmi dokument me rëndësi i cili ishte krijuar gjatë ri-gjykimit të pandehurit, K.H. ishte raporti i autopsisë ⁶ të kryer në viktimën në Spitalin Universitar të Gjenevës të datës 19 shtator 2006. Kjo ishte përcjellë nga autoritet zvicerane me kërkesë të kryetarit të trupi gjykues dhe nuk ishte vendosur para trupit të parë gjykues të Gjykatës së Qarkut të Pejës në 2007.

iv. I pandehuri

I pandehuri, **K.H.** e kishte dhënë deklaratën e tij në polici të Kosovës më 21 gusht 2006.

Para se të bëhej deklarata ai kishte konfirmuar e ishte këshilluar mbi të drejtat e tij ligjore se i kishte kuptuar këto të drejta dhe se avokati i tij mbrojtës i caktuar nga policia ishte prezent.

I dyshuari, K.H. kishte deklaruar se më 19 gusht 2006 në përafërsisht orën 15:00-15:30 ishte takuar me A.D. nga Bega-Shqipëri dhe A.K. nga fshati Dojan, Shqipëri në Bajram Curr, Shqipëri. Ai kishte deklaruar se është kërkuar nga ai që të kryej një vrasje në Kosovë. Ai është pajtuar që të bën këtë. Ai kishte shkuar në shtëpi që të merr pasaportën e tij dhe të ndërron rrobat e tij. Më vonë ai kishte deklaruar që e kishte lëshuar Kosovën me një Mercedes-Benz 240 ngjyrë gjelbër duke i mbajtur tabelat e regjistrimit nga Tirana në Shqipëri. Ai kishte deklaruar se nuk kishte armë në veturë pasi që A.D. kishte deklaruar se atyre do të ju jepeshin armët në Kosovë. Ai kishte deklaruar se ai nuk e dinte se kënd kishte për të vrarë por vetëm e dinte se vrasja do të bëhej për shkak të gjakmarrjes dhe se ai do të

⁶ Volumi 1 në Tab 10

informohej në Kosovë se kënd kishin për të vrarë. Përfundimisht ata kishin arrite në Pejë.

K.H. kishte theksuar se A.D. e kishte parkuar veturën në stacionin e autobusit. A.D. e kishte udhëzuar K.H. dhe A.K. për të pritë në veturë dhe pastaj e ka përcjellë atë ndërsa ishte duke biseduar me “atë”. Pas përafërsisht 15 minutash K.H. kishte theksuar se ai dhe A.K. kishin dalë nga vetura dhe e kanë takuar A.D. te një shtëpi tri apo katër katesh me një verandë të vogël dhe dy vetura në oborr. A.D. ishte duke biseduar me një person të cilin e kishte prezantuar si S.. K.H. kishte theksuar se ai e njihnte këtë person dhe se e kishte identifikuar atë përmes një fotografie që i ishte treguar nga policia. Ai kishte theksuar se A.K. dhe S. e njihnin njëri tjetrin.

K.H. kishte theksuar se grupi ishte ulur dhe përfshirë në një bisedë të vogël por nuk ishte diskutuar për “punë”. A.D. tregoi qëllimin e tij për tu kthyer në Shqipëri atë natë dhe S. i kishte treguar K.H. dhe A.K. për të shkuar në kafene aty afër për të pirë kafe.

K.H. kishte treguar se pas një gjysmë ore kishte ardhë S. dhe i kishte treguar atyre se A.D. kishte shkuar. S. kishte sjellë cigare për K.H. dhe A.K.. Ai kishte ndenjur për 30 minuta.

K.H. theksoi se ai dhe A.K. ishin pajtuar për të pranuar njëqind(100) euro secili dhe pistoleta nga S.. Pak më vonë ata u kthyen në shtëpi të S. dhe ai kishte deklaruar se ai do t'i dërgonte ato për të parë veturën e personit të cilin ata do ta vritnin.

K.H. tregoi se ata kishin shkuar në shtëpinë e këtij personi ku ishin takuar me tre të rinj të cilët i kishin dërguar ata te një diskotekë ku edhe ishin informuar se ndodhej ky person. Personi të cilin ai e kishte përshkruar, e kishte identifikuar një veturë për ata dhe ata ishin kthyer në shtëpinë e S.. K.H. theksoi se vetura ishte BMË, ngjyrë hiri me tabela të huaja të regjistrimit. Ai kishte treguar se tabela përpara ishte me ngjyrë të verdhë ndërsa ajo prapa ishte e bardhë.

K.H. tregoi se ata ishin dërguar për të parë rrugën ku do të vinte edhe personi i synuar dhe ku ata u informuan se do të ishte vendi i përshtatshëm për ta vrarë. Ai kishte theksuar se ata pastaj ishin kthyer në shtëpi të S. ku i ishin dhënë armët - A.K. e morri një pistoletë *TT* ndërsa ai një *Glock*. S. i pyeti ata nëse dëshironin që të merrnin një apo dy Kallashnikovë dhe ata vendosen të merrnin një. Gjatë kësaj kohe personat tjerë ishin prezent dhe ata ishin udhëzuar me telefon në lidhje me vendndodhjen e caktuar të tyre.

K.H. kishte treguar se atij i ishte dhënë një telefon Nokia me një Vala SIM kartelë dhe se numri ishte i ri dhe se ai do të thirrej në atë numër kur personi (caku) do të kishte qenë përafërsisht 5 minuta larg. K.H. tregoi se ai dhe A.K. ishin dërguar tek vendi ku kishin qenë më herët dhe se ata do të kryenin vrasjen.

Ai tregoi se ishte përafërsisht ora 00:00 apo 01:00 dhe ata u pajtuan që të fshinin Kallashnikovin dhe të largoheshin. Ata e fshihen Kallashnikovin dhe u kthyen në një rrugë me asfalt ku e kishin parë një shtëpi dhe në afërsi të saj ishin 10 apo 15 motoçikleta. K.H. tregoi se ata ishin ulur në

një pozitë galiç afër kësaj shtëpie dhe kishin diskutuar se a të flinin aty apo të ktheheshin në Pejë. Ai kishte theksuar se përderisa ishin duke biseduar, një motoçikletë me dy persona ishte duke ardhur drejt atyre. Ata i kishin fshehur armët e tyre. Personat në motoçikletë i kishin pyetur ata se çfarë ishin duke bërë aty? Ata i ishin përgjigje se kishin ardhë nga Shqipëria dhe thjesht dëshironin që të flinin në një vend. Ata ishin pyetur se mos kishin parë ndonjë lepur në afërsi , dhe ishin përgjigje që “jo”.

K.H. kishte treguar se këta dy persona ishin larguar me motoçikletë drejt shtëpisë ku ishin vendosur të gjitha motoçikletat ndërsa ai dhe A.K. kishin vazhduar drejt rrugës së asfaltuar. K.H. kishte theksuar se përderisa ishin duke shkuar drejt rrugës së asfaltuar ata kishin vërejte se e njëjta motoçikletë ishte duke i përcjellë ata. Të njëjti persona i kishin ndaluar K.H. dhe A.K. dhe ju kishin kërkuar letërnjoftimet e tyre. K.H. ju kishte treguar pasaportat e tyre por nuk ju kishte dhënë këto pasaporta. Dy personat e kishin pyetur K.H. dhe A.K. për të ndenjtur aty pasi që donin ta informonin policinë. K.H. kishte thënë se si ju kishte shpjeguar atyre se kishin ardhë nga Shqipëria dhe se ata nuk kishin ardhë aty për të vjedhur dhe se t'i linin rehat.

K.H. tregoi se si A.K. tashmë kishte ikur në këtë çast dhe se ai nuk e kishte parë më. K.H. tregoi se ai kishte vazhduar të ecë drejt rrugës së asfaltuar për një kilometër derisa e kishte parë një fushë me misër dhe se ai kishte qëndruar aty deri në mëngjes. Ai tregoi se e kishte marrë telefonin e tij dhe e kishte kyçur por aty kërkohej PIN numri, të cilin nuk e kishte dhe pastaj e kishte humbur SIM kartelën.

K.H. tregoi se në agim ai kishte ecur drejt rrugës së asfaltuar dhe për afërsisht 15 metra nga asfalti ai ishte takuar me një mashkull të cilin nuk kishte mundur ta përshkruante por kishte mbathe papuçe, kishte thënë ‘mirëmëngjesi’, e kishte kapur për dore dhe e kishte pyetur se ku e kishte “shallin”⁷ e tij. K.H. i kishte thënë atij se ai nuk kishte ndonjë “shall” por ky person e mbante për dore dhe e pyeste për pasaportën e tij. K.H. tregoi se i kishte thënë këtij personi se pasaportën e kishte në xhepin e tij dhe se nuk do t’ia jepte atij. Ai tregoi se si ky person e kishte kapur për zinxhirin e qafës dhe e kishte këputur atë. Megjithatë, ai e kishte lëshuar zinxhirin e qafës pasi që K.H. i kishte thënë atij se nuk do të ikte.

K.H. tregoi se mashkulli i kishte thënë *“ti mund të ikësh, dhe nëse e bën këtë do të shqyëj”*. Ai tregoi se të dytë kishin vazhduar rrugës së asfaltuar afër njëri tjetrit në drejtim të kundërt me Pejë. K.H. i kishte thënë atij mashkullit se ai donte ta informonte policinë. K.H. kishte thënë se ai ishte kthyer prapa në Pejë dhe kishte filluar të vraponte. Ai tregoi se si e kishte parë këtë personin duke i zbathur papuçet e tij dhe duke e nxjerrë armën e tij. Ai tregoi se si kishte filluar ta ndiqet me pistoletë në dorën e tij.

K.H. tregoi se kur ai ishte duke vrapuar për 50m, ai kishte dëgjuar personin i cili ishte duke e ndjekur atë, duke kërkuar nga një person në anën tjetër të rrugës për ta ndaluar atë. K.H. kishte theksuar se ky personi i dytë (më i vjetër) ishte mundur me ndaluar atë por ai i kishte thënë atij që të mbante distancën e tij ose do ta vriste. Ai tregoi se përderisa ishte duke e ndjekur ai e kishte nxjerrë armën e tij dhe i ishte kërcënuar.

⁷ Shënim nga përkthyesi: Në gjuhën Shqipe “shami” do të thotë shall ose shami koke dhe se sigurisht kanë nënkuptuar “shtëpi” që në gjuhën angleze është “a house”.

K.H. tregoi se në këtë çast personi i parë i cili ishte duke e ndjekur atë e kishte ngritë armën e tij dhe kishte qëlluar një herë. K.H. kishte theksuar se pas asaj krisme ai kishte ngritë dhe mbushur përsëri armën para se personi i parë ta qëllonte në të cilën pikë K.H. tregoi se ai kishte qëlluar mbi kokën e tij për ta frikësuar ate. K.H. tregoi “*se gjuajtjet e tilla me armë kishin vazhduar për 20-30m*” dhe përderisa të gjitha këta plumba ishin gjuajtur ai ende ishte duke u ndjekur nga ky person.

K.H. theksoi se ky person e kishte ndalur zjarrin për disa çaste dhe ndërsa ishte duke vrapuar ai e kishte kthyer kokën e tij prapa dhe se personi tjetër kishte qëlluar edhe njëherë me armë për herë të fundit dhe kishte dëgjuar ndjekësin e tij duke bërtite dhe e kishte parë duke u rrëzuar përtokë.

K.H. tregoi se ai e kishte kapërcyer gardhin afër dhe kishte ikur përmes livadheve dhe pyjeve. Ai tregoi se kishte vazhduar derisa e kishte ndalur policia. Ai kishte theksuar se ndërsa ishte duke ikur, ai e kishte fshehur armën e tij në një kanal të ujit në fshatin Radavc . Ai tregoi se ishte arrestuar nga policia në rrugën Radavc - Peje.

K.H. tregoi se para se të ndodhnin këto ngjarje, ai kishte qenë në Pejë disa herë. Ai kishte shkuar edhe në Gjakovë. Megjithatë, ai tregoi se nuk ishte takuar apo kishte dëgjuar për S. më herët. Ai tregoi se kishte dëgjuar që A.K. kishte thënë se ka qenë disa herë në Pejë në lidhje me këtë rast por se nuk e kishte kryer punën dhe se sa herë që kishte shkuar në Pejë ai i kishte marrë 100 euro. Ai tregoi se A.K. nuk i kishte treguar atij se me kënd ishte takuar herrave tjera apo se kush e kishte angazhuar ate.

Në lidhje me A.D., K.H. tregoi se ai nuk dinte për të kaluarën e tij por pasi që e dinte një rrugë të shkurtë për Pejë, kjo e kishte bërë atë që të mendonte se ai kishte qenë në Kosovë apo Pejë shumë herë.

K.H. ka treguar se vetura të cilën ai dhe A.K. është dashur ta gjuajnë ishte BMË me ngjyrë hiri, me tabela te huaja të regjistrimit. Tabela në anën e pasme ishte me ngjyrë të verdhë ndërsa në anën e përparme me ngjyrë të bardhë. Aq sa ai mund ta mbante ne mend , numri i regjistrimit ishte 1578, por ai nuk i kujtonte shkronjat dhe numrat tjerë.

K.H. tregoi se në lidhje me personin të cilin ai e kishte qëlluar, ai e kishte parë atë për herë të parë kur ishte ndalur nga ai dhe nuk mund ta përshkruante.

K.H. përfundoi duke thënë se atij dhe Ardianit i ishin premtuar nga 5000 Euro secilit nga A.D. për të kryer vrasjen 5000 Euro dhe se paratë do të ju jepeshin kur të kryenin punën dhe pastaj do të ktheheshin në Shqipëri.

Më 22 gusht 2006 i pandehuri, **K.H.** e kishte dhënë një deklaratë të shkurtë në polici të Kosovës në të cilën ai kishte deklaruar se përveç deklaratës së tij të dhënë në polici më 21 gusht 2006 atij ditën e nesërme i ishin treguar dy fotografi në të cilat ai e kishte identifikuar shtëpinë dhe lokalet ku më “10 gusht t 2006” ai kishte pirë birrë dhe koka kolla së bashku me A.K. dhe se këto pije ishin paguar nga S.K.. Ai gjithashtu e kishte identifikuar një porte të punuar me hekur të mbuluar me plastikë e cila dukej si xham. K.H. kishte treguar poashtu se në fotografi e kishte identifikuar një shtëpi me tre kate apo katër duke përfshirë kulmin. Ai gjithashtu e kishte identifikuar edhe një

shtëpi një katesh ku ishin parkuar tre veturat dhe ku ai *“ishte pajisur me armë nga personat e lartpërmendur më 19 gusht 2006”*.

I pandehuri, **K.H.** ishte ekzaminuar nga prokurori më 12 shtator 2006, 28 shtator 2006 dhe më 1 nëntor 2007. Përveç kësaj dhe me kërkesën e tij ai e kishte dhënë deklaratën në prokurori më 24 prill 2009 ndërsa ishte në paraburgim në Pejë.

Gjatë marrjes në pyetjet të tij më 12 shtator 2006 i pandehuri, K.H. kishte dhënë dëshmi të gjerë në lidhje me atë se si kishte ardhë në Pejë më 19 gusht 2006. Ai kishte përsëritë se si kishte shkuar në shtëpinë e S.K. me A.K. dhe se si A.D. menjëherë iku dhe u kthye në Shqipëri. Megjithatë, K.H. kishte thënë se kur A.K. e kishte informuar ate për vrasjen e propozuar dhe çështjen e parave dhe armëve, ata kishin kurdisur një plan që të marrin paratë dhe armët dhe menjëherë të ikin për Shqipëri. Në këtë pikë të pandehuri, K.H. iu kishte keqësuar gjendja dhe intervista ishte ndërprerë.

Në këtë rast, i pandehuri **K.H.** nuk ishte pyetur nga prokurori përsëri deri më 28 shtator 2006.

Ai theksoi se ishte takuar me A.K. në autolarje në Shqipëri më 19 gusht 2006. Ai ishte me A.D.. Ata e kishin ftuar të pandehurin, K.H. që të shkonte në Kosovë për të “kryer një punë”. Ai tregoi se si kishte shkuar në Kosovë me A.K. dhe A.D., me veturën e A.D. “Benz 240” të hirtë me tabela TR . K.H. kishte theksuar se A.D. i kishte thënë atij se në Kosovë nofka e tij ishte “Caf” dhe A.D. e informoi se në Kosovë ata do të kryenin vrasje për €5000.

A.D. tregoi se A.K. do të pranonte të njëjtat si dhe para për shpenzime dhe armë por se nuk tregoi nga kush do t'i pranonte. K.H. tregoi se A.K. e kishte ditë se nga kush do ti merrnin armët pasi që ai kishte theksuar se kishte shkuar në Kosovë më herët për të kryer vrasje, por ai tha se nuk i kishte kryer këto vrasje por i kishte marrë paratë dhe ishte kthyer prapa në Shqipëri.

K.H. kishte theksuar se atij i kujtohej se kishte arrite në Pejë në orën 17:00 apo 18:00. Ai tregoi se A.D. i kishte thënë atij që të priste në veturë dhe se ai do të shkonte te personi të cilin kishin ardhë për ta takuar. K.H. tregoi se ata më në fund ishin thirre në shtëpinë përballë stacionit të autobusëve me një kafene afër. Në shtëpi A.D. ishte me një mashkull që quhej S.. K.H. kishte theksuar se ata kishin ndenjur aty për 5 minuta dhe A.D. i kishte propozuar S. që K.H. dhe A.K. të shkonin nga shtëpia dhe të pinin kafe. Ashtu edhe vepruan.

K.H. pohoi se menjëherë më pas S. ia arriti dhe i kishte dhënë secilit nga një pako me cigare dhe i kishte thënë se A.D. kishte shkuar. Ai pohoi se S. u largua edhe ata u larguan dhe ecën përreth qytetit para se të takohej me ta përsëri S. me një veturë SUV dhe ata të gjithë së bashku u kthyen në kafenenë ku kishin qenë më herët dhe hyrën brenda dhe kishin pirë kafe. Pas disa minutash ata shkuan te S. ku ai i tregoi atyre se do të dërgohen për të parë veturën të cilën duhet me qëlluar. Ai theksoi se ata kishin shkuar në një vend ku kishte dyqane, diskoteka dhe para një diskoteke një person me ata i kishte treguar me gisht veturën në të cilën duhej të qëllonin. K.H. tregoi se vetura nuk kishte pasur tabela RKS dhe se ishte një BMË ngjyrë hiri. Ata u kthyen në veturën e tyre dhe ishin pyetur se nëse dëshironin që të dërgohen tek rruga ku do të bëhej prita. K.H. pohoi se ai dhe A.K. ishin pajtuar me

këtë. Ai kishte treguar se ata ishin transferuar në një veturë tjetër BMË me tabela RKS dhe ishin dërguar atje.

K.H. e kishte ndërprerë dëshminë e tij për të theksuar se në fillim, para se me shkuar tek shtëpia e S., ai dhe A.K. ishin pajtuar që secili prej tyre të merrnin €100 për të kryer vrasjen dhe pistoleta dhe pastaj të iknin në Shqipëri.

K.H. kishte thënë se kur arritën në vend ku do të bëhej prita aty kishte pasur disa mospajtime se ku do të ishte vendi më i mirë për të kryer vrasjen. Përfundimisht ai dhe A.K. ishin pajtuar që të kryhej në një rrugë fshati të paasfaltuar.

K.H. theksoi se pastaj të gjithë u kthyen në shtëpi të S. ku një djalosh i ri ju kishte sjellë atyre dy pistoleta “Glock”. Ai theksoi se ato ishin të ngjashme me të policisë dhe se ato ishin “Glock 17”, por njëra prej tyre nuk kishte pasur municion dhe një djalosh tjetër i ri që ishte aty kishte dalë dhe ishte kthyer edhe me një pistoletë, të modelit TT, dhe ju kishte sjellë atyre. K.H. theksoi se ai e kishte marrë pistoletën “Glock” dhe A.K. e kishte marrë pistoletën “TT”. Atyre ju kishin ofruar edhe *“një Kallashnikov apo dy”* dhe ata e kishin marrë vetëm një. Ata pastaj ishin dërguar në rrugën për në fshat të cilën e kishin vizituar më herët dhe ishin pajtuar me një veturë të tipit “Audi”.

K.H. theksoi se atyre nuk i kishin dhënë paratë të cilat iu kishin premtuar por atyre ju kishin dhënë një telefon në shtëpi të S.. Megjithatë, ai tregoi se njëherësh pasi që ishin në vendin e ngjarjes, ai e kishte shkyçur telefonin pasi që dëshironte t’i përmbahej planit siç ishte pajtuar më herët me A.K..

K.H. kishte theksuar se përderisa ata ishin duke pritur në veturë dhe ata kishin menduar se ishte një veturë e policisë dhe ai e kishte futur Kallashnikovin në kaçuba por pasi që kishte kaluar vetura ata kishin kuptuar se nuk kishte qenë veturë e policisë, kështu që ai e kishte marrë përsëri Kallashnikovin dhe ata kishin ecur afro 100m. dhe e kishin gjuajtur Kallashnikovin në një livadh në disa kaçuba por kjo ndërsa ishin duke ecur me A.K. rrugës për në asfalt në mënyrë që me i ikë veturës së policisë që i kishte kaluar. Ai tregoi se kjo kishte qenë rreth mesnatës.

K.H. tregoi se në këtë pikë ata kishin vërejtë një shtëpi e cila kishte disa motoçikleta dhe aty afër ishte një shtëpi e braktisur. Ai tregoi se ata i kishin kaluar ato shtëpi dhe ishin ndodhur në një livadh tjetër dhe ndërsa ishin duke ecur ishin kthyer prapa. Ai tregoi se i kishte propozuar A.K. që të flinin në livadh por ndërsa ata ishin në livadh, një motoçikletë me dy persona kishte arrite kështuqë ata i kishin gjuajtur pistoletat në kaçuba.

K.H. tregoi se personat në motoçiklete ishin ndalur dhe i kishin pyetur se kush ishin këta dhe se çfarë bënin aty. Ata kishin kërkuar pasaportat e tyre të cilat iu kishin treguar. Ai tregoi se si njëri prej dy personave në motoçiklete ishte më i moshuar dhe i pyeti nëse kishin parë lepuj. K.H. tregoi se këta persona ishin larguar më pas dhe se ai dhe A.K. i kishin marrë përsëri pistoletat dhe vazhduan të ecnin por personat me motoçikleta u kthyen dhe përsëri kërkuan pasaportat e tyre, të cilat ata i kishin treguar. K.H. tregoi se si në këtë pikë A.K. kishte ikur me vrap dhe ai nuk e dinte se ku dhe se nuk e kishte parë përsëri.

K.H. tregoi se ai ishte munduar që të ikte gjithashtu. Ai tregoi se kishte hyrë në një fushë me misër dhe se kishte qëndruar aty deri sa kishte aguar ku

pastaj kishte vazhduar drejt rrugës së asfaltuar në mënyrë që të kthehej në Shqipëri. Megjithatë ai tregoi se si ishte takuar me një person, i cili e kishte kapur për krahu dhe i kishte thënë atij që të shkonte me të në polici. Ai tregoi se si ky person e kishte kapur për fyti dhe kishte dashur ta grushtonte. Ai i kishte thënë që mos ta bënte këtë. Ai pohoi se mashkulli ishte munduar që ta kap për zinxhir në fyt por ai ishte liruar ku ky person ishte munduar me grushtuar përsëri. K.H. tregoi se si mashkulli e kishte kapur për krahu dhe ia kishte kërkuar pasaportën e tij por se ky nuk ia kishte dhënë.

K.H. tregoi se në këtë pikë ata të dy ishin duke ecur drejt rrugës së asfaltuar por në drejtim të kundërt. K.H. pohoi se mashkulli e kishte lëshuar dhe i kishte thënë *“ti nuk mund të vraposh ose do të shqyej”*. K.H. tregoi se si në këtë moment kishte vazhduar për dy apo tri hapa paralel me këtë mashkull por pastaj u kthye shpejt dhe kishte filluar të ikte drejt Pejës. Ai e kishte dëgjuar këtë mashkullin se si i kishte thënë rojës së sigurimit që ishte aty *“Ndale atë !”* dhe e kishte dëgjuar mashkullin se si e kishte mbushur pistoletën kështu që ai kishte reaguuar duke e nxjerrë pistoletën tij. Ai tregoi se i kishte thënë rojës *“Mos më ndalo mua pasi që do të vras!”* dhe roja nuk kishte reaguuar .

K.H. tregoi se në atë moment mashkulli kishte qëlluar dy herë në drejtim të tij dhe pas të shtënës së dytë edhe ai ia kishte kthyer gjuajtjen me qëllim që ta frikësonte por ai kishte vazhduar që të qëllonte në drejtim të K.H., kështuqë ky kishte qëlluar prapa në mënyrë që ta largonte por ai nuk ishte ndalur duke thënë *“Hej ndalo , ndalo !”*. Ai tregoi se si për një çast viktima ishte ndalur dhe nuk gjuante dhe edhe ky e kishte ndalur zjarrin por kur ky mashkull kishte filluar të gjuante përsëri edhe ky kishte vazhduar me

gjuajtur duke vrapuar kështu që ai nuk e dinte se në çfarë distance ishin larg prej njëri tjetrit.

K.H. tregoi se pas gjuajtjes ai i kishte kapërcyer disa pengesa, kishte kaluar pranë një veture deri në orën 14:00 vetëm ishte sjellë përreth pyllit dhe nuk e dinte se ku ishte duke shkuar derisa nuk ishte kapur nga policia në rrugën përgjatë Pejës. Ai theksoi se ende besonte se do të mund të vritej.

Në përgjigje të pyetjeve të prokurorit, i pandehuri, K.H. kishte pranuar se ishin disa mospërputhje në mes të asaj që ishte deklaruar më herët dhe asaj që ky e pohonte tani sidomos në lidhje me atë se si kishte ardhur në Pejë. I pandehuri, K.H. e kishte pranuar këtë. Ai tregoi se si ishte dashur të merrte €5,000 pagesë njëherësh pasi që të ishte kryer vrasja dhe se ai do të kthehej në Bajram Curr.

Ai pohoi se e njohte A.D. dhe A.K. prej më herët, ata ishin vendas por se ai nuk kishte miqësi me ata pasi që ishin më të vjetër.

Prokurori pastaj i kishte thënë të pandehurit se kishte një kundërshtim në mes të asaj që ai e dëshmoi tani me atë që e kishte dëshmuar më herët deri më tani, pasi që ai më herët kishte deklaruar se gjatë shkëmbimit me zjarr në mes të atij dhe viktimës, ai e kishte parë viktimën duke u rrëzuar në tokë ndërsa tani ai nuk e kishte deklaruar këtë. I pandehuri e mohoi se e kishte deklaruar këtë ndonjëherë dhe se atë që e thoshte tani ishte e vërteta.

Prokurori gjithashtu e kishte pyetur të pandehurin, K.H. nëse ai e njohte personin tjetër që kishte qenë në shtëpi të S. atë natë. Ai tregoi se nuk e njohte por mendonte se njëri prej tyre quhej V. ose V.. Ai tregoi se si policia i kishte treguar disa fotografi dhe se ai i kishte identifikuar dy persona.

Prokurori pastaj i kishte treguar atij disa fotografi dhe ai i kishte identifikuar personin në numrin 2 dhe 5 por nuk ishte i sigurve pasi që i kishte parë ata natën. Megjithatë, në përgjigje të pyetjes nga avokati mbrojtës i të pandehurit, V.K., i pandehuri ishte përgjigje se ai nuk e dinte nëse këta ishin persona të ndryshëm.

Në përgjigje të pyetjes nga avokati mbrojtës për të pandehurin, S.K., i pandehuri, K.H. tregoi se kur ata i kishin marrë armët në oborrin e S., aty kishin qenë edhe tre apo katër meshkuj tjerë.

I pandehuri kishte përfunduar duke i përsëritë pohimet e tij të mëhershme se kishte arrite në marrëveshje me A.K. që mos me e kryer vrasjen por vetëm ti marrin paratë dhe të ktheheshin në Shqipëri.

Më pas, më 6 prill 2007 i pandehuri, **K.H.** ishte në qendrën e paraburgimit në Pejë kur ai i kishte shkruar prokurorit duke e pyetur që të takohej me të për një çështje të rëndësishme. Prokurori kishte marrë pjesë më 24 prill 2007 kur i pandehuri K.H. e kishte dhënë deklaratën ku kishte pohuar se për afërsisht tri javë apo një muaj më herët të mërkurën rreth orës 12:30 një i burgosur A.R. i ishte kërcënuar atij dhe i kishte thënë që ta ndryshonte deklaratën e tij që e kishte dhenë para prokurorit duke i thënë atij se po që se nuk vepron kështu unë do të *“prej me zhilet”*. I pandehuri, K.H. pohoi se ai dyshonte që S.K. e kishte bindur A.R. që të bënte këtë. Ai gjithashtu kishte pasur presion nga A.K.⁸ për me ndryshuar deklaratën e tij në shkëmbim të 5.000 eurove, e cila ofertë i ishte komunikuar atij përmes një të burgosuri M.Xh. nga rajoni i Drenicës. K.H. tregoi se ai është dashur të thotë se ishte marrë nga Shqipëria në Kosovë nga A.D. e jo nga A.K..

⁸ Shënim nga përkthyesi, mbiemri i Ardianit është i pallexueshëm.

I pandehuri, **K.H.** e kishte dhenë deklaratën e tij të fundit në prokurori më 1 nëntor 2007. Në këtë ai e kishte përsëritur pohimin e tij të mëhershëm në lidhje me ndryshimin e deklaratës së tij dhe përsëri e kishte implikuar A.R. dhe M.Xh.. K.H. kishte theksuar se ai e kishte informuar një zyrtar të burgut të quajtur R.. Ai gjithashtu pohoi se nuk do ta ndryshonte deklaratën e tij për €10,000 e jo vetëm €5,000 të cilat pohon se i janë ofruar.

Përfundimisht, i pandehuri **K.H.** kishte dhënë dëshmi në mbrojtje të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Pejë më 19 janar 2015.

K.H. filloi duke dëshmuar se deklarata të cilën e kishte dhënë para policisë së Kosovës më 20 gusht 2006 ishte nxjerrë nga ai duke ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike nga policia. Ai kishte theksuar se policia kishin shkruar se ata kishin dashur dhe e kishin shtyrë ate me dhunë që të nënshkruante. Ai theksoi se avokati i tij mbrojtës nuk ishte prezent në kohën në atë kohë, vetëm se ishte zgjedhur një avokat mbrojtës nga policia në kohën kur e kishte nënshkruar deklaratën e fabrikuar.

K.H. e kishte përsëritur dëshminë e tij të mëhershme ku A.D. i kishte ofruar atij një punë në Kosovë ku kishte qenë dhe kishte punuar shumë herë më herët.

K.H. kishte deklaruar se ai fillimisht e kishte kuptuar që kjo punë ishte punë fizike dhe se ai kishte shkuar në Kosovë me A.D. dhe A.K. me veturën e tij Mercedes-Benz 240. Ai tregoi se kishin hyrë te kufiri *Qafa e Morinës* e cila ndodhet afër Gjakovës para se të arrinin përfundimisht në Pejë afër stacionit të autobusit.

K.H. u shpreh se ai dhe A.K. qëndruan në makinë, ndërsa A.D. shkoi për të biseduar në lidhje me mobilje ose veshje që ai kishte për t'i blerë, por pas rreth 5 ose 10 minutave ai dhe A.K. e lanë makinën dhe e kaluan rrugën dhe A.K. hyri në një shtëpi, e cila kishte një portë të madhe. Ai tha se sapo hynë brenda, S.K. iu ofroi kafe. K.H. u shpreh se ata hynë në një kafene, që ishte ngjitur me këtë shtëpi, e cila ishte brenda rrethojës së shtëpisë dhe jo shumë larg nga dera kryesore e hyrjes.

K.H. u shpreh se në atë moment A.K. i tha atij se ata kishin shkuar aty për të kryer një vrasje dhe jo për të bërë ndonjë punë. Ai deklaroi se reagimi i tij fillestar ishte që të ngrihej dhe të largohej, por A.K. e bindi që të rrinte, duke thënë se, në qoftë se ata do të përpiqeshin të largoheshin tani, ata kurrë nuk do të largoheshin të gjallë.

Në atë çast, K.H. u shpreh se ai u kthye në shtëpinë kryesore, ku S.K. ishte me dy meshkuj të tjerë, për të cilët ai supozoi të ishin djemtë e tij.

K.H. deklaroi se A.K. pati një bisedë me K.ët lidhur me vrasjen. Ai deklaroi se djemt e S.K. i morën ata dhe dolën jashtë dhe u shpjegoi se çfarë lloj makine viktime do të ngiste. Ai deklaroi që ai kujton se ishte një BMË metalike. Ai deklaroi se më vonë e pa atë të parkuar diku në Pejë, por ai nuk mund të mbante mend se ku. Ai ka deklaruar se ai dhe A.K. më pas u dërguan në një vend për ta vënë në pritë pronarin e këtij automjeti. Ata pastaj u kthyen në shtëpinë e S.K. dhe u dha atyre dy pistoleta njëra prej të cilave ishte një "TT". Atyre iu dha edhe një telefon me një SIM kartelë që të rrinin në kontakt dhe që të informoheshin kur të afrohej objektivi i qëllimit.

K.H. u shpreh se ai dhe A.K. përfundimisht u hodhën në Kashticë në anë të rrugës. Ai deklaroi se rruga nuk ishte e asfaltuar. Ai deklaroi se ai e fshehu një pushkë sulmuese AK-47, që ua kishin dhënë gjithashtu, në disa shkurre atje. Ai deklaroi se ai e fiku telefonin celular, të cilin ia kishin dhënë dhe ia hoqi SIM kartelën. Ai deklaroi se A.K. iu ankua atij në lidhje me këtë dhe e kuptoi se nuk ishte qëllimi i tij për të kryer vrasjen nga diskutimet e mëparshme që i kishin pasur në kafene.

K.H. deklaroi se A.K. u qetësua dhe u pajtuan se duhej të braktisnin detyrën e tyre dhe thjesht të iknin. Ata u larguan në drejtim të rrugës kryesore. Ai deklaroi se kaloi një makinë policie dhe nga kjo u shtua vendosmërinë e tyre për të ikur. Ai tha se ata shkuan në një fushë, ku kishte shenja se aty kishin kaluar automjete, motorë dhe kafshë dhe ata përfundimisht arritën deri te disa shkurre në mes të këtij livadhi. U ulën dhe qëndruan atje deri sa aty erdhën dy persona me një motoçikletë.

K.H. u shpreh se ata u ndalën dhe pyetën *"çfarë po bëni këtu, a po mundoheni të vidhni?"*, të cilëve ai iu përgjigj: *"Jo, ne jemi nga Shqipëria, nuk kemi para dhe ne nuk kemi vend se ku të flemë"*. K.H. u shpreh se këta njerëz u larguan por, pas rreth një apo dy minutave njëri prej tyre u kthye në këmbë dhe ai i kërkoi nga të dytë, K.H. dhe A.K. që t'ua tregonin atij pasaportat e tyre. K.H. u shpreh se ai ia tregoi pasaportën dhe të dy u pyetën nëse ata kishin parë ndonjë lepur.

K.H. u shpreh se ai mendoi se kjo ishte një pyetje e çuditshme dhe ai e pyeti *"Nëse ne nuk ju shqetësojmë, mund të qëndrojmë ose ne gjithashtu mund të largohemi"*, dhe ai personi u përgjigj: *"Jo, jo"*, dhe pastaj ai u largua vetë.

K.H. u shpreh se ai pastaj i tha A.K., *"Ne nuk mund të qëndrojmë këtu, sepse askush nuk dëshiron që ne të jemi këtu. Ne duhet të ikim nga ky vend"*.

K.H. deklaroi se ata shkuan drejt rrugës kryesore, por vetëm pak para asaj, u shfaqën përsëri ata dy personat me motoçikleta dhe kërkuan përsëri prej tyre që t'ua tregonin pasaportat. Ai deklaroi se në atë moment A.K. ishte larguar, por ai nuk e kishte parë atë. Ai deklaroi se pasoi një grindje e lehtë lidhur me prodhimin e pasaportës së tij dhe ai ishte kapur për krahu. Ai deklaroi se ai vendosi se duhej të ikte. Ai u përpoq të ikte dhe menjëherë hasi në një burrë më të vjetër dhe ai e pyeti nëse ai e kishte parë A. dhe ai i tha 'po' duke treguar me gisht në anën e djathtë të tij. K.H. u shpreh se edhe ai shkoi në atë drejtim, por nuk mund ta gjente A., kështu që ai u kthye prapa deri sa arriti në një shtëpi dy ose tre-katëshe. Ai deklaroi se ai vazhdoi të ecte në atë rrugë duke e kërkuar një rrugë shpëtimi.

K.H. u shpreh se ai arriti në një fushë me misër, ku qëndroi deri në mëngjes. Ai deklaroi se në mëngjes u largua nga aty në një rrugë të asfaltuar deri sa një person erdhi tek ai dhe e kapi për fyti dhe e pyeti, nëse ai ishte personi nga nata e kaluar dhe deshi që ta grushtonte atë.

K.H. u shpreh se sapo e kuptoi se ai donte ta grushtonte , i tha atij që të mos e bënte atë, pasi që kjo do t'i kushtonte atij. Ai deklaroi se ky person ia liroi fytin dhe e kapi atë për krahun e majtë me krahun e tij të djathtë dhe tha: "eja me mua". K.H. deklaroi se ky njeri ishte i veshur me rroba civile dhe pantallona të shkurtra dhe nuk dukej të ishte polic.

K.H. u shpreh se ai i tha këtij personi që t'ia lëshonte krahun,gjë të cilën e

bëri ai, por ai më pas e kapi për fyti dhe deshi që ta grushtonte përsëri. Ai deklaroi se ai i tha që mos ta bënte këtë, sepse do të pendohej dhe pastaj ai ia liroi fytin, por mori një copë druri në gjerdan rreth qafës së tij dhe ai u thye, pas së cilës ai shpejt ia kapi krahun përsëri. K.H. u shpreh se ky njeri ishte shumë agresiv dhe kjo e frikësoi atë.

K.H. u shpreh se ata ecën së bashku dhe shumë shpejt u gjendën në rrugën kryesore. Ai deklaroi se ishte duke ecur kundër vullnetit të tij, pasi ai burri e mbante për krahu. Ai deklaroi se si ky burri u përshëndet me një burrë më të vjetër, të cilin e takuan. Ai tha se kur arritën në rrugën e Kashticës ata shkuan në të djathtë. Ai deklaroi se ai i tha disa herë këtij personi që t'ia lironte krahun, por në vend të kësaj, ai e kapi për krahu dhe e shtypte edhe më shumë. K.H. deklaroi se ai personi i tha: *"ju nuk mund të largoheni, sepse unë do t'iu djeg"*.

K.H. u shpreh se ai ishte i frikësuar, por arriti që të lirohej nga kthetrat e atij burri dhe iku në drejtim të Pejës. Ai deklaroi se gjersa ishte duke ikur ai mund të dëgjonte një armë duke u mbushur. Ai deklaroi se ai kërkoi nga ai person që mos të gjuante. Ai deklaroi se e dëgjoi atë, duke i bërë titur një personi tjetër, *"ndale atë qen bir qeni!"*. Ai tha se një person ishte në rrugë aty kah ikte ai, dhe i hapi krahët për ta ndaluar atë. Ai tha se e nxori pistoletën dhe i tha *"mos më dil në rrugë, ose unë do të të vras. Mos më ndal, do të të vras!"*

K.H. ka deklaruar se ai nuk mund të ndalej, sepse personi që sapo e kishte mbushur armën, mund ta kishte vrarë atë. Ai deklaroi se pas atij momenti, ai nuk e di se sa më vonë, ai dëgjoi të shtënat. Ai deklaroi se e mbushi

pistoletën e tij, në të shtënë e dytë, dhe kjo ishte shumë afër tij dhe ai u shmang, pastaj e preku kokën e tij për të parë nëse plumbi e kishte goditur atë, por ai nuk kishte parë asnjë pikë gjak. Ai tha se ai e ktheu dorën dhe e ngriti atë prapa dhe u përpoq të gjuante, në mënyrë që ta frikësonte personin që përpiqej të shtinte në të. Ai deklaroi se ka pasur një shkëmbim zjarri. Ai deklaroi se nganjëherë vraponte drejtë dhe nganjëherë lëvizte herë në të majtë e herë në të djathtë, për të shpëtuar jetën. Ai tha se dikush gjuante me armë nga mbrapa në drejtim të tij, por ai gjithashtu qëlloi *"nga mbrapa."*

K.H. tha se kur të shtënat u ndalën, ai nuk shtiu. Ai tha se u largua nga rruga kryesore dhe eci në anën e djathtë. Ai deklaroi se ecte nëpër fusha dhe nëpër male. Ai ka deklaruar se ka dëgjuar njerëz duke folur, ndoshta në serbisht, dhe ai ishte i frikësuar, sepse mendonte se ai mund të ishte në Serbi, por ai pa makina me targa të Kosovës dhe e kuptoi se ishte në Kosovë.

K.H. u shpreh se ai e kaloi rrugën kryesore deri në atë që iu shfaq atij përpara e që ishte një kanal i ujitjes. Ai tha se ai ishte shumë i lodhur dhe nuk mund të ikte më. Ai deklaroi se ai e nxori pistoletën, e cila ishte bosh, sepse plumbi ishte *"jashtë vrimës"*, e futi plumbin në karikator, e futi karikatorin në pistoletë dhe e hodhi armën në kanal. Ai deklaroi se ai e bëri këtë, sepse ishte i frikësuar se mund të ndodhte një konflikt me dikë. Ai tha se ishte më mirë për të, që ai të vritej nga dikush se sa ai ta vriste dikë.

K.H. deklaroi se pastaj shkoi në rrugën kryesore të asfaltuar, ku ai e pa një makinë policie. Ai deklaroi se ata ia bënë me dorë dhe ata u ndaluan. Ata pyetën nëse ai kishte parë një burrë nga Shqipëria, i cili ishte këtu. Ai deklaroi se ai u përgjigj *"nëse jeni duke kërkuar për një person , në të cilin*

njerëzit kanë shtënë në drejtim të tij dhe ai ia ktheu me të shtëna, ky jam unë''.

K.H. deklaroi se ata ia vunë prangat në duar dhe filluan ta torturojnë. Ata e kapën për flokësh dhe e ia hodhën kokën në mbulesën e makinës. Ai tha se ata e futën në makinë dhe rrugës për në stacionin e policisë e rrahën në makinë. Ai deklaroi se ai nuk ishte në gjendje të jepte deklaratë. Ai deklaroi se ai iu tha atyre se e kishte humbur armën e tij dhe ata i thanë që t'i çonte në vendin ku kjo kishte ndodhur. Ai tha se të nesërmen ai i çoi ata atje dhe ua gjeti armën.

Në përgjigje të një pyetjeje nga Kryetari i trupit gjykues, K.H. deklaroi se në momentin kur personi i ndjerë e kapi për krahu dhe për fyti, ai nuk e kishte vënë re nëse ai person mbante ndonjë armë me vete.

Në përgjigje të pyetjes së Prokurorit, i pandehuri, K.H. u shpreh se ai dëgjoji duke u mbushur arma, ai tha: *"Mos gjuaj!"*, sulmues i tij i tha një personi tjetër *"Ndale atë qen bir qeni!"*. Ai përsëriti se ai burri më i vjetër u përpoq për ta ndaluar atë, duke i hapur krahët e tij dhe ai tha: *"Mos më ndal, përndryshe unë do të të vras!"*, dhe më pas, kur ai iku, të shtënat vazhduan .

Prokurori pyeti se nga e shtëna e parë që ai e dëgjoji, a mund ta dinte se ishte larg nga personi, i cili kishte shtënë? I pandehuri, K.H. u shpreh se ai nuk e dinte distancën me personin pas tij, por sipas mendimit të tij, ishte një distancë e shkurtër në fillim. Kur trupi gjykues ngulmoi për këtë, ai deklaroi se ishte rreth 5 ose 6 metra.

K.H. u shpreh se ndjekësi i tij fillimisht qëlloi me dy të shtëna para se ai t'ia kthente me të shtëna. Ai deklaroi se pas të shtënës së dytë e kuptoi se të shtënat ishin në drejtim të tij. Ai theksoi se shkëmbimi i zjarrit vazhdoi, por nga kujtesa ai nuk mund të thoshte se edhe sa të shtëna u gjuajtën, edhe pse ai e dinte nga provat e nxjerra në rastet penale pasuese. Ai tha se ishte çështje e jetës ose vdekjes në atë kohë dhe ai nuk i kishte numëruar të shtënat.

K.H. u shpreh se kur iu referua "mbushje" e armës, ai e kishte fjalën mbushjen e armës, duke e vënë plumbin në tytën e armës dhe ju duke e futur në karikator.

K.H. pastaj e tregoi pozicionin, në të cilin ai ishte kur kishte shtënë me armën e tij.

K.H. u shpreh se ai ishte duke vrapuar për të ikur, dorën e kishte pas shpinës dhe te drejtuar përpjetë. Ai tha se kur vazhduan të shtënat, ai nuk kishte kontroll më në armën e tij dhe kishte frikë për jetën e tij. Ai ka deklaruar se, gjersa ishte duke vrapuar, ai e ndërronte drejtimin herë në të majtë dhe herë në të djathtë dhe jo gjithmonë drejtë. Ai deklaroi se në këtë moment ai nuk mund të shihte personin, i cili ishte duke shtënë në të. Ai ka deklaruar se kur ai nuk i dëgjoi më të shtënat, ai gjithashtu u ndal së shtëni.

K.H. u shpreh se para se ta fshihte pistoletën e tij në kanal, ai e hoqi karikatorin. Ai deklaroi se një plumb doli nga pistoleta dhe ai e mori këtë plumb, e futi në karikator dhe e futi karikatorin në pistoletë dhe e hodhi atë në ujë. Ai besonte se në atë kohë në armë ishin dy plumba.

Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i tij mbrojtës, i pandehuri, K.H. përsëriti pretendimin e tij të mëhershëm se policia e kishte rrahur atë dhe e kishte përgatitur deklaratën e tij. Ai deklaroi gjithashtu se pas të shtënës së parë që ai e gjuajti, ai vazhdoi të vrapojë nga e djathta në të majtë dhe nuk u kthye ose të kthehej mbrapa asnjëherë për të parë se ku gjendej sulmuesi i tij. Pasi Trupi gjykues këmbënguli në këtë pyetje, ai deklaroi se ai nuk e kishte kthyer kokën prapa, duke drejtuar dhe duke gjuajtur, duke u përpjekur për t'u siguruar se ai e kishte goditur viktimën. Kur u pyet për të shpjeguar se si një e shtënë e tillë e paqëllimtë të mund të përfundonte në një "të shtënë në kokë" i pandehuri, K.H. përsëriti se ai nuk kishte vënë në shenjë para se të gjuante. Ai ka deklaruar se ai nuk kishte kontrollë në dorën apo në krahun e tij. K.H. u shpreh se ai e mbante të fshehur armën e tij në pjesën e përparme të xhinseve (pantallonave) të tij. Ai ka deklaruar se ai e mbushi atë pasi u gjuajt e shtëna e parë dhe ai e ktheu zjarrin pas të shtënës së dytë.

Në përgjigje të një pyetjeje nga trupi gjykues, i pandehuri, K.H. u shpreh se ai nuk mund të tregonte distancën midis vetes dhe ndjekësit të tij. Ai ka deklaruar se ai nuk ishte trajnuar për përdorimin e armëve, por ai kishte manovruar dhe e kishte përdorur armën më parë, pasi që ishte prishur rendi dhe ligji në Shqipëri në vitin 1997 dhe depot e armëve ishin sulmuar dhe si rezultat, pothuajse të gjithë kanë pasur qasje në armë.

K.H. u shpreh se ai ishte në një gjendje të keqe psikike në ditë. Ai tha se ishte i lodhur. Ai ka deklaruar se nuk ishte i qetë dhe kishte frikë. Ai theksoi se në mendje tjetër ai nuk do të kishte reaguar ashtu siç bëri ndaj veprimeve të njeriut që e ndaloi atë. Ai ka deklaruar se sikur ta dinte se ky njeri ishte i armatosur, ai nuk do të kishte ikur dhe ta kthente shpinën. Ai ka deklaruar se

ai do ta kishte nxjerrë pistoletën e tij dhe do të kishte kërkuar që ai ta nxirrte armën e tij dhe do të kërkonte nga një qytetar për të thirrur policinë për të zgjidhur problemin me ta. Ai ka deklaruar se ai fillimisht nuk ka parë se ky person posedonte armë. Ai deklaroi se ai njeri u soll shumë keq ndaj tij, ai ishte agresiv dhe kërkonte që ta largonte atë kundër vullnetit të tij. Ai ka deklaruar se ai nuk besonte se qëllimi i atij njeriu ishte që ta çonte atë në polici.

K.H. tha se kur të shtënat filluan, ai ndjeu se jeta e tij ishte në rrezik. Megjithatë, ai tha se kur ia ktheu me të shtëna, qëllimi i tij nuk ishte për të vrarë ndokënd, por më tepër për të pohuar sulmin ndaj tij. Ai ka deklaruar se ai u përpoq të ikë, por njeriu vazhdoi të shtinte në të dhe sikur ai të mos ia kishte kthyer me të shtëna, ai nuk do të ishte gjallë sot.

K.H. e përsëriti deklaratën e tij të mëparshme se, në asnjë moment gjatë shkëmbimit të zjarrit nuk ishte kthyer dhe nuk kishte shtënë në drejtim të viktimës ballë për ballë. Ai ka deklaruar se ai shikonte në të gjitha drejtimet, por kjo ishte me qëllim të gjetjes së një rruge për të shpëtuar. Ai deklaroi se e vetmja rrugë praktike për të shpëtuar, ishte ajo rruga që ai e mori.

K.H. tha se kur të shtënat u ndalën ai nuk shtiu më dhe se vetëm vraponte për të ikur. Ai nuk e kishte parë viktimën në atë moment. Ai ka deklaruar se ai nuk kishte shikuar përreth për të parë se çfarë kishte ndodhur. Ai ka deklaruar se ai thjesht kishte vazhduar rrugën dhe ishte arratisur. Ai theksoi se hera e fundit që ai e kishte parë të ndjerin ishte kur ai ia lëshoi krahun dhe i tha: *"ju nuk mund të ikni, sepse unë do të të djeg"*, sepse atëherë ai ecte dy deri në tre hapa dhe pastaj ai ishte kthyer dhe nuk e kishte parë më atë.

K.H. deklaroi se para se ta hidhte armën, ai e hoqi karikatorin. Ai deklaroi se e mori plumbin dhe e futi në karikator, e vuri karikatorin në pistoletë dhe më pas e hodhi pistoletën nën atë bllok betoni në kanal. Ai deklaroi se karikatorin kishte plumba brenda dhe plus një tjetër ai e nxori nga tyta, kështu që të paktën dy plumba, nëse jo më shumë, gjendeshin në karikator pas të shtënave.

K.H. u shpreh se ai u dorëzua vetë në polici, për shkak se ai nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur dhe për të mbrojtur veten. Ai ka deklaruar se ai nuk e dinte se ai e kishte vrarë të dëmtuarin.

K.H. përfundoi duke deklaruar se ai i tregoi policisë se ku e kishte hedhur armën e tij, sepse ai donte të ishte realist dhe të thoshte të vërtetën, pasi që ai nuk kishte asgjë për të fshehur. K.H. deklaroi se ai e hodhi armën dhe nuk e fshehu atë.

v. Inspektimi i vendit të ngjarjes

Trupi gjykues vendosi për të inspektuar vendin e ngjarjes. Inspektimi u zhvillua më 12 shtator 2014. I pandehuri, K.H. ishte i pranishëm së bashku me mbrojtësin e tij. Palët e dëmtuara u informuan gjithashtu. Dëshmitari/Pala e dëmtuar, Sa.O., i cili kishte qenë deri tani me banim në Gjermani dhe ishte subjekt i një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare për të marrë dëshminë e tij, mori pjesë gjithashtu. Kjo kërkesë më pas u anulua.

Në fillim mbrojtësi i të pandehurit, avokati M.R. deklaroi se *locus* kishte

ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme që nga incidenti. Zyrtari E.B. nga Policia e Kosovës ishte Shef i Hetimeve dhe ai deklaroi se oborri i viktimës në atë kohë ishte plot me motoçikleta për shitje dhe ata besonin se të pandehurit kishin ardhur aty për të vjedhur. Ai pastaj tregoi se çfarë kishin deklaruar palët tjera, se ishte hapur grindja në mes të pandehurit, K.H. dhe viktimës dhe si pala e dëmtuar A.B. i kishte dëgjuar të shtënat dhe ishte plagosur. Ai tha se K.H. dhe A.K. ishin angazhuar nga K.ët për të vrarë të dëmtuarin, V.I. i cili jetonte në fshatin Kashticë.

Zyrtar E.B. pastaj foli para trupit gjykues me anë hartës së policisë mjekoligjore lidhur me vendin e ngjarjes dhe ka deklaruar se cili numër (1-23) përputhej me cilë pjesë të provave. Ai theksoi se vendin ku i pandehuri, K.H. e kishte hedhur pistoletën e tij nën një urë, ishte rreth tri fshatra larg.

I dëmtuari Sa.O. ishte i pranishëm. Ai i dha të dhënat e tij personale dhe nga ai u kërkua që të paraqitej në gjykatë më 24 shtator 2014 në orën 10: 00 për të dhënë dëshmi zyrtarisht dhe ai ra dakord për ta bërë këtë.

Ai i tregoi trupit gjykues, se ku i kishte hasur për herë të parë të pandehurit në natën e 19 gushtit dhe në agim të datës 20 gusht 2006. Ai konfirmoi se ai ishte në një motocikletë me L.O. në atë kohë. Ai e tregoi bisedën që kishin pasur në lidhje me arsyen e pranisë së tyre atje.

I pandehuri K.H. u dërgua në locus dhe ai shpjegoi atë që ai dhe A.K. kishi bërë kur kishin arritur. Ai shpjegoi se si zona kishte ndryshuar shumë që nga viti 2006.

K.H. përshkroi se si ai kishte rënë në kontakt me Sa.O. dhe L.O., se si A.K. kishte ikur dhe se si ai u strehua në një fushë me misër deri në mëngjes. Ai pastaj e përshkroi se si ai kishte rënë në kontakt me të ndjerin, J.O. dhe se si kishte ndodhur një grindje mes tyre dhe se ishte gjuajtur me të shtëna dhe se viktima dhe A.B. u qëllua. Ai ka deklaruar se ai qëlloi prapa dhe lart, në ajër dhe nuk kishte mundur ta kontrollonte dorën e tij gjersa shtinte mbrapa. Ai theksoi se kishte ndryshuar vendi i saktë ku kishte rënë viktima.

Sa.O. pastaj u kthye dhe i tregoi trupit gjykues, ku ai e gjeti të vdekurin. Ai ka deklaruar se ai ishte i shtrirë në shpinë dhe ende merrte frymë.

C. Vlerësimi i provave

Konkluzionet faktike

Ky rast ka pasur një histori të gjatë dhe ndonjëherë histori komplekse procedurale.

I pandehuri, K.H. u akuzua fillimisht me tri vepra penale të pretenduara në aktakuzë PP. nr. 387/06 domethënë:

Akuza 1:

Bashkimi kriminal si bashkë-kryes (së bashku me A.K., S.K., Xh.K. dhe V.K.) në kundërshtim me nenin 26 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së për të kryer veprë penale Vrasje e rëndë, në kundërshtim me nenin 147 paragrafi 1 pika 9 të KPPK-së.

Akuza 2:

Vrasje e rëndë në kundërshtim me nenin 147, paragrafit 1 pika 4 të KPPK-së.

Akuza 3:

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe municionit në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 2 të KPPK-së.

Pas shqyrtimit gjyqësor në rastin P. nr. 538/07 Gjykata e atëhershme e Qarkut në Pejë i kishte liruar të gjithë të pandehurit e dy veprave të para të sipër-përmendura me anë të Aktgjykimit të datës 18 dhjetor 2007. Megjithatë, të pandehurit, Xh.K., K.H. dhe A.K. ishin dënuar për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve të zjarrit dhe u dënuan me një vit e katër muaj burgim, të cilën kohë tashmë ata e kanë vuajtur në paraburgim. Prokurori parashtroi ankesë kundër pafajësisë. Me anë të Aktgjykimit Ap. Nr. 267/09 të datës 27 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës e aprovoi ankesën e prokurorit, anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e referoi çështjen për rigjykim, por vetëm në lidhje me Akuzat 1 dhe 2. Gjykata Supreme e la në fuqi vendimin e shkallës së parë në lidhje me dënimin për Akuzën 3 (d.m.th. vepra e armëve të zjarrit).

Kur çështja u kthye për ri-gjykim ajo u mor përsipër nga Gjyqtarët e EULEX-i dhe iu caktua numri P. nr. 542/11. Rigjykimi filloi më 7 Maj 2012. Të pandehurit K.H. dhe A.K. u thirrën në mënyrë të rregullt, por ai nuk u paraqiten. Kryetari i atëhershëm i trupit gjykues kontaktoi me autoritetet relevante në Republikën e Shqipërisë, të cilët deklaruan besimin e

tyre se të pandehurit, edhe pse qytetarë të Shqipërisë, nuk ishin brenda juridiksionit të tyre. Me urdhër të datës 27 qershor 2012 Kryetari i atëhershëm i trupi gjykues e solli çështjen kundër K.H. dhe A.K. dhe lëshoi urdhra kombëtare dhe ndërkombëtare për arrestimin e tyre. Rasti kundër këtyre të pandehurve, A.K. dhe K.H. ishte caktuar me numrin P. nr. 267/12.

Tre të pandehurit tjerë (S.K., Xh.K. dhe V.K.) u liruan nga një vendim i Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 24 korrik 2012, kryesisht për shkak se të pandehurit, K.H. dhe A.K. nuk ishin në dispozicion për marrje në pyetje në mënyrë të tërthortë, prandaj dëshmitë e tyre nuk mund të përdreshin kundër bashkë të pandehurve. Prokurori paraqiti ankesë ndaj lirimit të tyre. Megjithatë, me anë të Aktvendimit PAKR. Nr. 1401/12 të datës 9 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën.

I pandehuri, K.H. u arrestua në Suedi më 12 shtator 2013 dhe ishte vendosur në paraburgim në bazë të një urdhëri për paraburgim të Gjykatës Themelore të Hudiksvallit i datës 4 Tetor 2014. Më 20 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Suedisë vendosi se nuk kishte asnjë pengesë ligjore për aprovimin e kërkesës për ekstradimin e të pandehurit, K.H. në Kosovë. Më 20 mars 2014 Qeveria e Suedisë e aprovoi kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për ekstradimin e të pandehurit, K.H. në Kosovë. K.H. nuk e dha pëlqimin për ekstradimin e tij. Ligji i aplikueshëm suedez është Ligji mbi Ekstradimin në Çështjet Penale, 1957: 668. I pandehuri, K.H. arriti në Prishtinë më 13 prill 2014. Ai u shfaq para trupit gjykues në Gjykatën Themelore të Pejës në orë 11:00 më 14 prill 2014 për një seancë dëgjimore për paraburgim dhe u mbajt në paraburgim, ku ai qëndroi gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor.

Më 27 maj 2014 prokurori paraqiti një amendament të aktakuzës, në të cilën ai e tërhoqi veprën në Pikë 1 kundër të pandehurve, K.H. dhe A.K.. Me të njëjtin ndryshim prokurori kishte për qëllim për të ndryshuar Pikën 3, por ai nuk mundi ta bënte këtë, pasi që kjo në Aktgjykimin e datës 27 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës së atëhershme të Qarkut në Pejë, duke i dënuar të pandehurit për këtë vepër. Ky vendim ishte i formës së prerë dhe nuk mund të prishej.

Në fund të fundit, i pandehuri, K.H. u ri-gjykua në lidhje me vetëm një vepër të pretenduar, dmth Vrasje të rëndë apo Pika 2 në aktakuzë.

Në shqyrtimin e shkresave të lëndës në rastin P. nr. 538/07, trupi gjykues arriti në përfundimin se procesverbalet ishin tepër të shkurtëra dhe ofronin ndihmë të kufizuar në përgjithësi në rastin konkret. Në të vërtetë kjo pikëpamje u rihorse në vlerësimin e Trupit Gjykues të Gjykatës Supreme të Kosovës në Aktgjykimin Ap. nr. 267/2009, datë 27 tetor 2009, në të cilën ajo vuri në dukje se Gjykata e atëhershme e Qarkut në Pejë kishte dështuar për të kryer një shqyrtim të detajuar të mjaftueshëm të të gjitha provave, në veçanti në lidhje me shkëmbimin kritik të të shtënave të armëve në mes të pandehurit, K.H. dhe të ndjerit, J.O..

Trupi gjykues gjithashtu vuri në dukje me shqetësim se Trupi gjykues i Gjykatës së atëhershme të Qarkut në Pejë kishte dështuar për të marrë një raport të autopsisë në lidhje me të ndjerin, J.O.. Me fillimin e rigjyimit, trupi gjykues i rigjyimit menjëherë e kërkoi këtë raport nga autoritetet zvicerane dhe ajo iu ishte siguruar nën letrën shoqëruese të datës 1 shtator

2014.9

Në shqyrtimin e provave në këtë rast trupi gjykues u pajtua se ishte e rëndësishme për t'u marrë parasysh provat me rend, duke përfshirë edhe ngjarjet para grindjes fatale në mes të pandehurit, K.H. dhe të ndjerit, J.O. në kryqëzimin e rrugës Pejë/Banje/Istog në orët e hershme të mëngjesit të 20 gushtit 2006.

Trupi gjykues e shqyrtoi deklaratën përmbyllëse të të pandehurit, K.H., në të cilën ai deklaroi se ai kishte ardhur në Pejë me A.K. dhe A.D.n për të ndërmarrë disa punë që kishin të bënin me dru ose mobilje. Ndërsa nuk kishte asnjë detyrim ligjor për të pandehurin për të treguar të vërtetën, në këtë pikë trupi gjykues nuk mundi tjetër, vetëm që të mbetej në faktin se kjo ishte hera e parë që ai e ka përmendur këtë arsye. Më parë ai kishte deklaruar 10 se qëllimi i vërtetë i vizitës së tyre i ishte zbuluar atij nga A.K. para se të largoheshin nga Shqipëria më 19 gusht 2006. Ky qëllim ishte për të kryer një vrasje për shpërblim financiar, pra të kryenin një vrasje të kontraktuar. Trupi gjykues gjen se në fakt, i pandehuri, K.H. u informua për qëllimin e vërtetë të udhëtimit të tij në Kosovë, para se ai të largohej nga Shqipëria dhe ishte në dijeni se nga ai kërkohet që të kryente një vrasje.

S.K. i dha një deklaratë Policisë së Kosovës më 22 gusht të vitit 2006, në të cilën ai mohoi të ishte takuar me të pandehurit, K.H., A.K. dhe A.D. në Pejë më 19 gusht 2006. Ai gjithashtu ka mohuar të kishte qenë në dijeni në lidhje me ngjarjet fatale në kryqëzimin e rrugëve Istog/Banje/Pejë në mëngjesin e

⁹ Shqyrtimi gjyqësor, Dosja Volumi X në tab. Y

¹⁰ Deklarata në Policinë e Kosovës më 19 gusht 2006 dhe Procesverbali i marrjes në pyetje nga ana e Prokurorit më 28 shtator 2006

hershëm të datës 20 gusht 2006. Ai ka deklaruar se hera e parë kur mori vesh për to, ishte kur policia erdhi për ta arrestuar atë dhe djemtë e tij, Xh. dhe V. të nesërmen. Ai madje e mohoi të njihje dikë nga Shqipëria ose që të kishte kontakte me dikë në Shqipëri. Trupi gjykues konstaton se kjo është aq e pa gjasë sa që të fyejë gjykimin e shëndoshë.

V.K. i dha një deklaratë Policisë së Kosovës më 22 gusht të vitit 2006, në të cilën ai gjithashtu mohoi të ishte takuar me të pandehurit, K.H., A.K. dhe A.D. në Pejë më 19 gusht 2006. Ai gjithashtu ka mohuar të kishte pasur njohuri apo të ishte përfshirë në ngjarjet fatale në kryqëzim e rrugëve Istog/Banje/Pejë në mëngjesin e hershëm të 20 gushtit 2006.

Trupi gjykues konstaton se në fakt, S.K., ose personat që kanë vepruar në emër të tij, kishte kërkuar nga të pandehurit, K.H., A.K. dhe A.D. për të udhëtuar në Kosovë dhe për të vrarë të dëmtuarin V.I., për të cilën gjë do të merrnin një shpërblim financiar dhe i pandehuri, K.H. e pranoi këtë ofertë. Nëse kjo gjë ishte kërkuar nga i pandehuri, K.H. në mënyrë të drejtpërdrejt apo përmes A.K., kjo është çështje e spekulimeve dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të gjetur se kjo gjë ishte kërkuar nga i pandehuri, K.H. në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Pasi i pandehurit, K.H. arriti në Pejë, trupi gjykues e pranon versionin e tij të ngjarjeve që ai u dërgua në shtëpinë e S.K.t ku u diskutua vrasja dhe Xh.K., V.K. (dhe ndoshta edhe të tjerë) e çuan për ta parë makinën në të cilën do të udhëtonte viktimat që synohej. Ai gjithashtu u dërgua në locus para se të kthehej në shtëpinë e S.K., ku atij dhe A.K. iu ishin dhënë armët, një telefon dhe disa para. Përfundimisht ata u dërguan përsëri në locus duke mbërritur

rreth mesnatës me 19 gusht 2006.

Trupi gjykues gjithashtu pranon se në një moment të pandehurit, K.H. dhe A.K. diskutuan që të mos i dëgjonin udhëzimet e tyre, të hiqnin dorë nga vrasja, t'i merrnin paratë dhe të ktheheshin në Shqipëri. Nuk është e qartë nëse kjo u ra dakord në fillim në Shqipëri, e cila është e mundur, por nuk ka gjasa, ose, më shumë të ngjarë, u diskutua, kur ata e gjetën veten të vënë në anë të rrugës në afërsi të fshatit Banjë afër mesnatës.

Provat e palës së dëmtuar, Sa.O. është e rëndësishme në këtë pikë. Trupi gjykues konstatoi se ai ishte një dëshmitar i ndershëm dhe i besueshëm. Ai ka deklaruar se në një moment të caktuar rreth mesnatës i pandehuri, K.H. dhe A.K. ishin në ose rreth pjesës së shtëpisë së familjes së O. dhe e tërhoqi vëmendjen e Sa.O. dhe kushëririt të tij L.O., të cilët ishin duke hipur në një motor atje. Jo pa arsye, Sa.O. besoi se të pandehurit, K.H. dhe A.K. nuk ishin për diçka të mirë atje dhe i pyeti ata që të shpjegonin se kush ishin dhe çfarë pune kishin atje.

Trupi gjykues i pranon provat e Sa.O. se vetëm K.H. kishte folur dhe e kishte informuar atë se ata ishin nga Shqipëria, ishin dërguar atje nga S.K. dhe ai e kishte treguar pasaportën e tij. Trupi gjykues gjithashtu e pranon dëshminë e Sa.O. se në atë moment A.K. iku dhe i pandehuri, K.H. e ndoqi atë jo shumë kohë më pas. Sa.O. deklaroi se ishte në këtë moment kur ai i telefonoi xhaxhait të tij J.O. dhe i tha se ishin disa persona nga Shqipëria prapa shtëpisë së tij.

Në këtë pikë lidhet dëshmia e palës së dëmtuar S.O., gruaja e të ndjerit J.O..

Ajo ka deklaruar se djali i saj, L. e thirri të ndjerin J.O., i cili ishte duke luajtur shah në shtëpinë e të vëllait të tij aty afër dhe rrugës, gjersa kthehej në shtëpinë e tij ai hasi në A.K. dhe e ktheu prapë në shtëpinë e tij nga ku ai i telefonoi policisë, e cila erdhi nga Istogu për ta dërguar A.K. në paraburgim.

Duket se kur policia u largua me A.K., të dytë, edhe Sa.O. edhe J.O. shkuan edhe ata në Stacionin Policor në Istog për të dhënë deklarata në polici para se të ktheheshin në shtëpinë e J.O., ku ata të dy do ta kalonin pjesën e mbetur të natës. Në këtë pikë vendndodhja e të pandehurit, K.H. nuk është verifikuar, por nga deklaratat e tij, ai ishte fshehur në një fushë më misër.

Duket se pastaj mbretëroi një periudhë e qetë dhe e pasivitetit në zonë për afërsisht deri në orën 05:45, kur gruaja e të ndjerit, S.O. deklaroi se ajo dëgjoi një zhurmë përjashta që e zgjoi atë dhe burrin e saj. Burri i saj, tani i ndjeri, J.O. doli përjashta për të parë se çfarë po ndodhte. Trupi gjykues gjen se në fakt ai u armatos me një pistoletë Sig Sauer. Pas jo më shumë se dhjetë deri në pesëmbëdhjetë minuta ai u ndesh me të pandehurin, K.H.. J.O. e kapi të pandehurin, K.H. dhe në mënyrë efektive e detyroi të ecte përpara, duke e shtyrë nga mbrapa në drejtim të shtëpisë së tij nga ku ai ndoshta e kishte qëllimin që ta thërriste policinë, ashtu siç kishte bërë kur ai e ndaloi A.K. më herët.

Në këtë pikë, dy deklaratat e vetme të hollësishme të asaj se çfarë kishte ndodhur, janë ato të të pandehurit, K.H. dhe dëshmitarit A.B.. Trupi gjykues konstatoi që A.B. ishte një dëshmitar mbresëlënës dhe i besueshëm. Aty ku atij i kujtohej diçka, ai shpjegonte në hollësi dhe ishte i pa rezervë në përshkrimin e tij. Megjithatë, aty ku nuk i kujtohej, ai thjesht thoshte se nuk i

kujtohej.

Nga një shqyrtim i thellë i dëshmisë së dëshmitarit, A.B. dhe të pandehurit, K.H., duket se në një moment të caktuar, gjersa po iu afroreshin rrugës kryesore Pejë/Istog, i pandehuri, K.H. u përpoq që t'i ikte J.O.. Ai e dinte se ai ishte duke u dërguar në polici dhe në fund të fundit ai do të hetohej për posedim të paligjshëm të armëve dhe ndoshta lidhur me shoqërimin e tij me familjen K.. Duke qenë i drejtuar nga J.O. dhe i kapur për krahu dhe për fyti K.H. u shkëput dhe vrapoi dhe pasi që ai ishte më i ri dhe më i shëndetshëm se J.O., ai fitoi terren shumë më shpejt dhe e bëri J.O. të besonte se ai nuk do të jetë në gjendje për ta ri-kapur atë.

Në këtë pikë nuk ka prova të besueshme për të kundërshtuar pohimin e të pandehurit, K.H. se J.O. qëlloi për herë të parë dhe ndoshta edhe për herë të dytë. Në mënyrë të ngjashme nuk ka prova të besueshme për të kundërshtuar dëshminë e mëvonshme të të pandehurit, K.H. se J.O. kishte vazhduar të shtinte në të dhe ai ia kishte kthyer zjarrin në vetëmbrojtje dhe pa u ndalur, pa u kthyer dhe vënë në shënjestër, por gjatë tërë kohës duke ikur, duke bërë zig-zage nga e majta në të djathtë, duke duke u përballur me drejtimin e kundërt dhe duke mos pasur kontrollë të vërtetë mbi trajektoren e plumbave të tij që shkonin mbrapa tij.

Trupi gjykues e konsideron me vend të theksojë se ka pasur dëshmitarë të tjerë të pranishëm në vendin e ngjarjes në atë kohë, por askush nuk mund të ofrojë një deklaratë të qartë dhe të detajuar të asaj që kishte ndodhur në mes të të pandehurit, K.H. dhe J.O.. Trupi gjykues ra në kontakt me dëshmitarin G.L. në Zvicër dhe bëri të gjitha përpjekjet për të siguruar dëshminë e tij në

shqyrtimin gjyqësor, por ai e bëri të qartë se ai nuk kishte asnjë dëshirë për t'u kthyer në Kosovë për këtë qëllim dhe në fund ai nuk iu përgjigj më thirrjeve telefonike dhe e-mailave të trupit gjykues.

Nga raporti i autopsisë është e qartë se i vdekuri, J.O. kishte pësuar një plagë me armë zjarri në anën e djathtë të kokës dhe kjo doli të ishte fatale. Ai gjithashtu kishte pësuar një plagë në shpatullën e majtë, por kjo nuk ishte fatale. I dëmtuari A.B. e pranoi atë që, me pranimin e tij, ishte një plagë e lehtë sipërfaqësore në krahun e tij. Dëshmitari ekspert Dr.A.G. mundi vetëm të deklaronte se e shtëna fatale ishte gjuajtur nga një largësi prej më shumë se një metre.

Në thelb, rasti i prokurorisë ishte se, gjersa nuk kishte asnjë dëshmi për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, K.H. e kishte vrarë të dëmtuarin, J.O., në krahasim me vrasjen e tij për vetëmbrojtje, kishte prova rrethanore të mjaftueshme për të konkluduar se ai e kishte bërë këtë.

Së pari, prokuroria vuri në dukje se i pandehuri, K.H. gjendej në atë vend, siç e kishte pranuar edhe vet ai, për të kryer një vrasje. Ai nuk ishte zgjedhur rastësisht për këtë, por më tepër për shkak se ai kishte përvojë në këtë drejtim dhe për këtë arsye është e logjikshme se ai e kishte bërë këtë, në fakt, e kishte kryer vrasjen, edhe pse nuk ishte personi, për të cilin ai ishte kontraktuar për ta vrarë. Megjithatë, trupi gjykues mendon se, ndërsa kjo është dëshmi se i pandehuri, K.H. ishte një njeri me pak ndershmëri kur vinte puna për marrjen e jetës njerëzore, kjo nuk është dëshmi se ai qëllimisht ia mori jetën të ndjerit, J.O. gjatë shkëmbimit të zjarrit që kishte ndodhur mes tyre.

Së dyti, prokuroria pohoi se fakti që i ndjeri kishte marrë një plagë fatale në kokë është në përputhje me pretendimet e një të shtënë në shënjestër nga një sulmues, i cili kishte përvojë në këtë drejtim. Prokuroria debaton versionin alternativ të ngjarjeve, d.m.th. i pandehuri, K.H. nuk ka pasur qëllim dhe fakti që ai rastësisht e goditi viktimën në kokë, nuk është thjesht e besueshme. Megjithatë, trupi gjykues mendon se ndërsa dëshmia e dy "gjuajtjeve", duke përfshirë një "të shtënë në kokë" është provë *prima facie* për të shtënat që janë bërë me qëllim, gjithashtu është e vërtetë se i pandehuri, K.H. shkarkoi gjithsej dymbëdhjetë të shtëna, që do të thotë se dhjetë nuk e kanë goditur të ndjerin, J.O. dhe ndërsa një e ka goditur të dëmtuarin, A.B. (duke i shkaktuar një plagë sipërfaqësore) nëntë plumba (ose 75% e atyre që u shkarkuan) ishin në shënjestër dhe kjo është në përputhje me dëshmitë e të pandehurit, K.H., d.m.th. se ai kishte qëlluar pa pasur shënjestër dhe bile nuk kishte shikuar në të njëjtin drejtim.

Prokuroria argumentoi gjithashtu faktin se pasi që ai i iku J.O., i pandehuri, K.H. e kërcënoi palën e dëmtuar A.B., se do ta vriste, është gjithashtu dëshmi e rëndësishme e qëllimit. Përsëri trupi gjykues konstaton se, ndërsa kjo dëshmi është në përputhje me përshtypjen që i pandehuri, K.H. kjo nuk është dëshmi vendimtare e sjellë ndër mend nga Prokurori, në të cilën gjatë tërë kohës bie barra e provave, që ai qëllimisht e kishte vrarë të ndjerin, J.O. gjatë shkëmbimit të zjarrit që kishte ndodhur mes tyre.

Në fund, prokuroria argumentoi dëshmitë e të pandehurit, K.H. se ai e hodhi armën e tij, kjo ishte në përputhje me një njeri, i cili e dinte se ai kishte kryer një vepër penale dhe donte të shkatërronte provat. Kjo sigurisht nuk ishte në përputhje me provat e të pandehurit se ai ishte një i huaj i frikësuar

në një vend të huaj, i cili nuk e dinte se ai kishte vrarë ose edhe plagosur J.O. dhe, për aq sa ai e dinte, ai ende po ndiqej gjersa po ikte nëpër fusha në drejtim të Pejës. Ndërsa trupi gjykues e konsideroi këtë një pjesë të mirë të provave rrethore, përsëri kjo nuk ishte provë pozitive vendimtare, që K.H. qëllimisht e kishte vrarë të ndjerin, J.O. gjatë shkëmbimit të zjarrit që kishte ndodhur mes tyre.

Në fund të fundit, e vetmja dëshmi e hollësishme e asaj që kishte ndodhur gjatë shkëmbimit të zjarrit në mes të të pandehurit, K.H. dhe të ndjerit, J.O. doli nga vetë K.H.. Nuk kishte asnjë dëshmitar tjetër të besueshëm, i cili do të mund të dëshmonte se në një moment të caktuar e kishte parë të pandehurin, K.H. të ishte kthyer, të kishte marrë në shënjestër dhe, duke lëvizur apo duke qëndruar, të kishte marrë në shënjestër, të kishte shtënë bile edhe një herë në të ndjerin, J.O.. Si rezultat i kësaj, trupi gjykues nuk mund të mos llogarisë mundësinë që i pandehuri, K.H. kishte shtënë në vetëmbrojtje të nevojshme duke qenë para një situatë kërcënuese për jetë dhe nuk e kishte vënë në shënjestër, por kishte gjuajtur mbrapa në drejtim të përgjithshëm të J.O., ndërsa shikonte në anë të tjera dhe ndërsa vraponte për të ikur dhe dy nga dymbëdhjetë plumbat që ai i gjuajti e goditën të ndjerin, plumbi në kokë doli të jetë fatal. Në thelb, versioni i të akuzuarit në lidhje me ngjarjet ngritën një dyshim të vërtetë të arsyeshëm në mendjen e trupit gjykues, që dëshmitë e prokurorisë thjesht nuk e hoqën dhe në ligj, trupi gjykues ishte i detyruar për t'i besuar të pandehurit, pa marrë parasysh se si, në anën tjetër, sjellja e tij konsiderohej e pandershme apo e pakëndshme.

Ligji përkatës

Neni 8 i KPK parasheh se nuk është vepër penale vepra, e cila është kryer në mbrojtje të nevojshme. (paragrafi 1) Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi (paragrafi 2). Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme (paragrafi 3). Kryerësi, i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryerësi i tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi (paragrafi 4). Gjykata konstaton se referencë për "tronditje e fortë apo frikë" gjersa shkruhet si e ndarë ajo mund të aplikohet dhe të interpretohet si e bashkuar.

Përfundim

Çështja thelbësore e Gjykatës për të vlerësuar është nëse i pandehuri, K.H. u sulmua në mënyrë të paligjshme, në qoftë se sulmi ishte i vërtetë dhe i pashmangshëm dhe nëse veprimet K.H. në përgjigje ishin në proporcion me rrezikun që vinte nga veprimet e viktimës J.O..

Nga sa më sipër, trupi gjykues ka nxjerrë këto përfudime. I pandehuri, K.H. e kishte perceptuar se ai ishte nën një sulm të vërtetë, të paligjshëm dhe të pashmangshëm që nga koha kur J.O. e kishte kapur për krahu dhe gjatë gjithë të shtënave që u shtinë në të. Gjykata ndan të njëjtin mendim. Të mbahesh dhe të kërcënohesh pa asnjë arsye të justifikueshme dhe pastaj të

qëllohesh pandërprerë, është padyshim një sulm i kundërligjshëm, real dhe i pashmangshëm.

Trupi gjykues pastaj u kthye për të pyetur, nëse veprimet e të pandehurit, K.H. ishin në disproporcion me shkallën e rrezikut që paraqitej nga sulmi i J.O..

I pandehuri pohoi se gjatë gjithë kohës që lidhet me atë ngjarje, ai ishte duke vepruar në vetëmbrojtje të ligjshme të nevojshme. Kur të vendoset lidhur me këtë çështje, Gjykata duhet të ketë parasysh faktin se (i) një person që vepron për një qëllim të ligjshëm mund të mos jetë në gjendje për të peshuar me një finesë masën e saktë të çdo veprimi të nevojshëm dhe (ii) dëshmia e një personi, që ka bërë vetëm atë çfarë ai person me ndershmëri dhe instinktivisht e kishte menduar se ishte e nevojshme për një qëllim legjitim, përbën dëshmi të forta se vetëm veprimi i arsyeshëm është marrë nga ai person për këtë qëllim. Gjykata mund të marrë parasysh çështjet e tjera, kur të përcaktojë nëse forca e përdorur ishte, në rrethana, e arsyeshme.

Nga Gjykata kërkohet që të ushtrojë një gjykim nëse forca e përdorur ishte e arsyeshme në rrethanat - duke përfshirë natyrën e rrezikut me të cilin u përball – ashtu siç i pandehuri e kuptoi të ishte.

Nëse shkalla e forcës së përdorur nga i pandehuri, K.H. ishte e arsyeshme në rrethanat, duhet të vendoset duke iu referuar rrethanave, të cilat ai besonte të ishin. Arsyeshmëria ose e kundërta e këtij besimi është relevante për pyetjen nëse ai vërtet e mbajti atë. Shkalla e forcës së përdorur nga i pandehuri, K.H. duhet të konsiderohet si të kishte qenë e arsyeshme në rrethanat ashtu siç ai

besonte të ishin, nëse forca e përdorur ishte proporcionale në ato rrethana.

Gjykata konstaton se J.O. luajti një rol të panevojshëm agresiv në ngjarjet që kishin ndodhur gjatë natës. Gjykata konstaton se vendimi i tij për tu armatosur dhe për tu larguar nga shtëpia e tij rreth orës 5:45 në mëngjesin e 20 gushtit 2006, në ndjekje të një personi, i cili nuk paraqiste asnjë kërcënim të menjëhershëm ose të rëndë ndaj tij apo familjes së tij, ishte i dalldisur (guxim i tepruar). Trupi gjykues ka mendimin se J.O. duhet të kishte mbetur brenda, t'i kishte mbyllur dyert dhe dritaret me dry (edhe pse nuk kishte prova se i pandehurit, K.H. ndonjëherë u përpoq të hyjë në shtëpinë e tij) dhe ta thërriste policinë. Fakti që ai nuk e ka bërë këtë është edhe më i çuditshëm, duke pasur parasysh faktin se ai e kishte thirrur tashmë policinë më herët që në mëngjes dhe kishin ardhur dhe e kishin dërguar A.K. në paraburgim.

Gjykata konstaton se kur i pandehuri, K.H. u shkëput nga kthetrat e J.O. dhe u përpoq për të ikur, ishte J.O. ai, i cili qëllon dy të shtënat e para në shkëmbim të mëvonshëm të të shtënave të armëve mes tyre. Përsëri, kjo ishte sjellje e panevojshme agresive. Nuk kishte asnjë provë se i pandehuri, K.H. kishte vjedhur ndonjë pronë nga J.O. apo kishte bërë ndonjë kërcënim tjetër ndaj tij apo familjes së tij. Gjykata ka pikëpamjen se J.O. thjesht është dashur që ta lejonte të pandehurin, K.H. të largohej nga vendi i ngjarjes dhe ta thërriste policinë. Në vend të kësaj, përdorimi i armës nga ana e tij e kishte rrëmbyer dhe provokuar një reagim nga i pandehuri, K.H., i cili do të ishte me pasoja tragjike Gjykata konstaton se J.O. ishte agresori.

Nëse sulmi ishte i menjëhershëm dhe i rrezikshëm, personi që ishte duke u

sulmuar ka mundur bile që në fillim të sulmit të përdorte dhunë më të madhe, me qëllim që ta mbronte veten e tij. Ai nuk ka nevojë të presë që të lëndohet i pari. Nevoja për vetëmbrojtje përfshin të drejtën për të ndaluar një sulm kërcënues për jetë, siç u qëllua pandërprerë gjersa ishte duke ikur nga sulmuesi. I pandehuri, K.H. e kishte perceptuar gjendjen të jetë e vërtetë dhe kërcënuese për jetë dhe kjo duhet të merret në konsideratë. Provat në rastin e mbështetin këtë perceptim. Prokurori nuk ka treguar se i pandehuri, K.H. kishte ndonjë rrugë tjetër të lirë për shpëtim në atë kohën. I pandehuri, K.H. u shpreh se ai nuk kishte asnjë alternativë tjetër, veç se të vraponte ikte dhe t'ia kthente me të shtëna në mënyrë që të shpëtonte jetën e tij. Kjo pikëpamje mbështetet nga trupi gjykues. Gjykata konstaton se dhuna e përdorur nga K.H. nuk ishte në disproporcion me shkallën e rrezikut që paraqitej nga J.O. dhe prandaj ai nuk mund të gjendet fajtor për akuzën kundër tij. Dëshmitari, A.B. ka deklaruar se i pandehuri nuk ishte në gjendje të synonte ndonjë gjë, sepse ai ishte duke vrapuar në të njëjtën kohë. Në fund të fundit, i pandehuri, K.H. u shpall i pafajshëm për veprën e Vrasje e rëndë, sepse, ndërsa gjykata ishte e bindur se ai gjuajti të shtënën që e vrau të ndjerin J.O., ai e bëri këtë duke vepruar në vetëmbrojtje të nevojshëm dhe veprimet e tij ishin në proporcion me nivelin e kërcënimit ashtu siç i perceptoi ai të ishte. Ndërsa ka pasur disa prova rrethore për të hedhur poshtë këtë dhe për të mbështetur versionin e prokurorisë rreth ngjarjeve (dmth. se i pandehuri, K.H. e ka pasur qëllim dhe me qëllim e ka vrarë J.O.) prokuroria ka dështuar të provojë këtë në mënyrë të pranueshme për trupin gjykues. Versioni i të pandehurit rreth ngjarjeve, dmth. se ai ia ktheu me të shtëna gjersa ishte duke u përballë me drejtimin e kundërt dhe duke ikur dhe nuk e kishte vënë në shënjestër viktimën, ishte i mundur dhe një herë ajo ka krijuar një dyshim të arsyeshëm në mendjen e trupit gjykues, trupi gjykues ishte i detyruar ta

ushtronte këtë në favor të të pandehurit, K.H., megjithëse jotërheqëse, ai e konsideroi sjelljen e tij ndryshe.

Për të gjitha arsyet e mësipërme e nxjerrim këtë Aktgjykim.

Më datë 3 mars 2015.

Gjyqtarja Marie Tuma
Kryetare e trupit gjykues

Gjyqtari Arkadiusz Sedek

Gjyqtari Arben Mustafa

Azem Havolli
Procesmbajtës

MJETE JURIDIKE: Në bazë të nenit 398 (1) të KPP-së, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit. Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar përmes Gjykatës Themelore të Pejës në Gjykatën e Apelit të Kosovës.